ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE
çdo të shtunë
Themelues • Kryeredaktor
BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 25 PRILL 2020. NUMËR 76. VITI II I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Azem Deliu dhe Andreas Dushi, janë padyshim, dy talente të spikatur të letërsisë sonë. Të lindur pas vitit 1990, njëri nga Skënderaj dhe tjetri nga Shkodra, në një dialog të sinqertë, të mençur, për krijimtarinë e tyre dhe të kolegëve, për politikat kulturore dhe rezidenca për përkthyes nga gjuhë të ndryshme që mungojnë, që letërsia shqipe të përballet me dinjitet me letërsitë e tjera.

AZEM DELIU & ANDREAS DUSHI

Kultura bashkon atë çka politika kërkon të ndajë

JERONIM DE RADA – NJË PAMJE JOHISTORICISTE

nga Arben Veselaj

Sipas Mateo Mandalàsë, poezia e De Radës nuk është aspak problematike, por janë kritikët dhe studiuesit letrarë ata që nuk e kanë nivelin mjaftueshëm të lartë për ta kuptuar letërsinë e tij.

(fq. 5)

STUDENTËT E LETËRSISË NË DITËN BOTËRORE TË LIBRIT

nga Lili Sula

(fq. 12)

Departamenti i Letërsisë i Universitetit të Tiranës kremton në të 12 vit Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit përmes veprimtarish që përcjellin vlerën e librit në transmetimin e dijes e të kënaqësisë së leximit. Ky vit erdhi ndryshe, na munguan auditorët, na mungoi një pjesë e veprimtarive që hijeshonin ambientet e brendshme e të jashtme të Fakultetit për çdo 23 Prill e që e shndërronin atë në ditë feste për studentë e pedagogë.

SI TA SHKRUEJ QYTETIN?

Rasti i Shkodrës

nga Ardian Ndreca

(fq. 6)

PSIKONARRATIVA E ZHGJËNDRRËS

(*Aksidenti* i Kadaresë)

nga Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)

(fq. 13)

NËPËR UDHËN E DASHURISË – HAJKU NGA NASHO JORGAQI

nga Giuseppe Schirò Di Maggio

(fq. 11)

(fq. 18)

PROTOTIPI I ANA KARENINËS ISHTE VAJZA E PUSHKINIT

TREGIME

Granit Zela: *Miniatura* (fq. 8)

Ismet Aliu: *Unë dhe vajza nga dimensioni tjetër* (fq. 12)

Rikard Ljarjes nuk i del qielli

ese nga Roland Gjoza

(fq. 10)

Njeriu Vitruvian

ese nga Moikom Zeqo

(fq. 14)

Andreas Dushi dhe Azem Deliu

Kultura bashkon atë çka politika kërkon të ndajë

Andreas Dushi: Përshëndetje Azem. U bë kohë që nuk dëgjojmë të tjerë lajme përpos atyre që lidhen me Covid-19, si nga Kosova, ashtu edhe nga Shqipëria ndaj ky dialog rreth diçkaje tjetër, besoj është gjëja e duhur. Pavarësisht situatës, a ka ndonjë aktivitet kulturor apo letrar këtë periudhë në Kosovë?

Azem Deliu: Gjithçka po zhvillohet, por asgjë s'po zhvillohet, Andreas. Para dy ditësh kisha një ligjëratë online, dhe një të tillë e kam edhe sot. Përpiqemi ta mbajmë gjallë jetën kulturore, dhe ky dialog është mes këtyre përpjekjeve, por megjithatë kjo është jetë e një rrethane paralele. Gjithsesi, unë konsideroj që letërsia e ka përfitimin e vet nga këto situata kufitare të qenies. Do të doja shumë ta dija edhe mendimin tënd për këtë.

Andreas Dushi: Mendoj njëjtë sikur ti. Duket që situata po kthehet në favor për artin dhe letërsinë, por ja që, kam frikë mos e gjitha vjen për shkak të një lloj "presioni" i cili domosdo, e detyron njeriun ta shohë këtë kohë ashtu sikurse e shumta kërkon. Këndej kufirit, një konkurs për "librin e karantinës" duket se ka marrë udhë, por nuk jam i sigurt a ka si shkak faktin që shkrimtarët tani mund të kenë kohë të lirë, apo është pasojë e një "prodhimtarie në nivele të larta".

Gjithsesi, duke qenë në këtë temë, më intereson pikëpamja jote rreth aktiviteteve letrare (si çmime kombëtare etj.) që zakonisht quhen "të letrave shqipe", por përfshijnë veç njërën anë të kufirit. Mendon se letrat shqipe duhet të kenë kufij?

Azem Deliu: Ka një dilemë të madhe që e ka shoqëruar njerëzimin në këtë kuptim. Nuk e di karakterin e konkursit në fjalë prandaj s'dua t'u hyj

në hak, por dua të trajtoj një dilemë me rëndësi. Si të identifikohen autorët? Me pasaportë? Me prejardhje? Me vendin ku aktualisht jetojnë?

Në të gjitha dilemat e "gjakut" nuk japim dot përgjigje sepse identifikimi me gjakun e me prejardhjen ka kohë që është tejkaluar në mendimin, sidomos perëndimor, për letërsinë dhe jo vetëm. Megjithatë, mesa duket, bota ka gjetur një drejtpeshim në këtë dilemë: autorët identifikohen, jo me prejardhjen apo pasaportën apo vendin e jetesës, por me gjuhën në të cilën shkruajnë. Kjo është gjë e mirë sepse po të ishte ndryshe, Kafka nuk do të bënte pjesë në studimet gjermanike të letërsisë ndërsa pjesën tonë të letërsisë në mërgatë, do ta humbisnim edhe ne. Letërsia shqipe, si çdo letërsi tjetër, identifikohet me gjuhën që e prodhon dhe kjo është, për mua të paktën, e saktë. Duke qenë kështu, është ironike, deri edhe qesharake, që një letërsie edhe ashtu të vogël e që merr frymë ndërkombëtarisht me vetëm një grusht shkrimtarësh, t'i vizatojmë kufij politikë e administrativë. Nëse ka një gjë që letërsia e refuzon, ajo është jeta e administratës, e politikave apo ofiqeve.

Kam pasur rastin në dialog me botues të të gjitha trojeve, duke e përfshirë këtu botuesin tonë të përbashkët, Onufrin, të dëgjoj ankesa lidhur me vështirësitë e shpërndarjes së librit të Kosovës në Shqipëri, e edhe anasjelltas (ndonëse më pak) për shkak të politikave jo të drejta tarifore, veçanërisht në kufijtë politikë. Pra, duket se ajo politika që tentojmë ta shpërfillim, megjithatë ndikon në jetën tonë, duke i dëmtuar botuesit, pa të cilët ne s'kemi kontakt me lexuesin.
Si thua ti? Sa janë gjasat që të bëjmë jetë mirëfilli kulturore e letrare duke e shpërfillur fare politikën? Apo megjithatë duhet ta fusim në llogaritë tona "dorën e shtetit"?

Andreas Dushi: Për fat të mirë, konkursi në fjalë ka dalë jashtë këtyre kornizave të cilat, për letërsinë, koha i ka kthyer në të paqena duke përdorur si pasaportë, gjuhën e shkrimtarit. Por çështja mendoj se duhet parë në një perspektivë që lëviz nga e shkuara, në të tashmen. E gjithë linja, qysh prej shkrimtarëve arbëreshë, deri te shkrimtarët e sotëm të diasporës, mendoj se përfaqëson një prej pjesëve të letërsisë shqipe për të cilën duhet të jemi më së shumti krenarë.
Dora e shtetit ja që është aq e gjatë, sa pa ndonjë mund të madh ia del të hyjë në shumëçka që edhe nuk i takon. Thënë kjo, mendoj se vetëm shpërfillja e saj është e pamjaftueshme, duhet një refuzim përbuzës, sikurse bëhet përballë gjërave që ta neverisin.

Ndonëse e di se etimologjikisht nuk qëndron si arsyetim, le të themi kultura është ura e cila lidh atë çka politika, për arsye meskine kërkon të ndajë.

Por mendoj se folëm mjaft për politikë. Shpesh, shkrimtarët kanë humbur miqësi njëri me tjetrin për këtë arsye (Nuk e them këtë pse i druhem, fjala vjen, fatit të Borgesit dhe Sabatos)! Personalisht ti, a e ke kthyer këtë kohë në dobi tënden? Po e përdor për diçka, ndoshta ndonjë projekt të ri?

Azem Deliu: Patjetër. Jetën e shkrimtarit e kam zhvilluar, pak a shumë normalisht. Kam mbajtur ligjërata e takime publike (ndonëse në rrethanat e paralelizmit "online"), kam dhënë intervista dhe kam marrë pjesë në kërkesa të publikut, nga më të ndryshmet. Kjo sa i përket anës publike të asaj që po e quaj, pa të drejtë ndoshta, "jeta e shkrimtarit".

Jetën e vërtetë të shkrimtarit, atë në bibliotekën time dhe studion e punës, e kam bërë normalisht si gjithmonë. Kam pritur që do të përfitoj më shumë nga kjo kohë, por nuk ndodhi ashtu. Vazhdova me ritmin e njëjtë. Shkruaj kritikën javore të librit në Gazetën Metro në Kosovë, lexoj për kërkesa të Universitetit dhe shije të miat, dhe shkruaj letërsi pak a shumë normalisht. Nuk përfitova, siç e thashë, nga "ngujimi". Ndoshta ngaqë, mesa duket, mbyllja brenda për të lexuar a shkruar ka kuptim veç kur dalja jashtë është opsion. Në të kundërt, nuk është domosdo produktive. Të paktën këtë shpjegim e gjeta për veten. Si mendon ti?

Andreas Dushi: Kam përshtypjen se të shkruarit e prozës lidhet me eksperiencën, ndaj kjo mbyllje, më e shumta mund të të ndihmojë të shohësh të shkuarën në një tjetër këndvështrim, ndërsa për të ardhmen, për pak gjë shërben. Ndoshta pikërisht për këtë arsye, jam marrë me rishikim e "Marrja e gjakut" duke e bërë gati për botimin në italisht, pasi e gjitha të mbarojë (çka shpresoj mos të jetë shumë vonë) dhe kam mbledhur e riparë disa tregime shkruar këtu - aty gjatë vitit që lamë pas. Përgjithësisht, ruaj të njëjtin model pune, pa ndonjë rregull të qartë.

Pavarësisht dëshirës, e kam të vështirë t'i përgjigjem kërkesës së lexuesit, ndaj edhe një mesazh apo e-mail nga kushdo që lexon diçka

ANDREAS DUSHI

Marrja e gjakut

OnufriRoman

timen këto kohë, më gëzon më shumë se ndonjë kritikë serioze në kohëra të tjera. Duke qëndruar këtu, si është për ty raporti i lexuesit tonë, me letërsinë shqipe?

Azem Deliu: S'di ç'të them. Në parim, raportet e mia me lexuesin, sidomos atë të Kosovës, janë në parim të mira. Ka një diferencë mes Kosovës dhe Shqipërisë sa i përket letërsisë sime, e këtë diferencë po përpiqem ta fashis. Në Kosovë, Azem Deliu njihet më shumë, por librat e tij më pak. Në Shqipëri, Azemi njihet fare pak, e librat lexohen pak më shumë. Prapë, bazën e lexuesit e kam në Kosovë, por gjithsesi kjo diferencë vërehet. Një herë, kur isha në Panairin e Tiranës (më duket se ka qenë viti 2017, ngaqë në 2018 doli "Shënimet e krimbit Smolinski"), në trotuar jashtë Pallatit të Kongreseve, dy vajza po bisedonin për "Puthësin e paligjshëm" dhe e kishin secila nga një kopje të tij në dorë. Unë kalova andej, dhe ato, ndonëse më panë, nuk më njohën fare. Është pak e çuditshme ngaqë fotografia ime është në kopertinë, por gjithsesi më dha kënaqësi. Më dha të ndieja një miklim të ndërgjegjes që nuk e kam ndjerë më parë.

Meqë e përmenda edhe "Shënimet e krimbit Smolinski", që tani është në garë për Çmimin e Unionit Europian për Letërsi, nuk kam si ta shmang falënderimin që ndiej ndaj teje, për vërejtjen e një gabimi në tirazhin e parë, të cilin e përmirësova menjëherë në ribotim. Kush mund të thotë se edhe ti nuk je pjesë e suksesit të librit? Në fakt, dua të të bëj një pyetje pak më të përgjithshme. Sa mendon se jemi pjesë e sukseseve të njëri-tjetrit si shkrimtarë shqiptarë? Nuk e kam fjalën këtu vetëm te ndjenja njerëzore e gëzimit (që e ndjeva dhe unë kur kuptova që do të botohesh në italisht), por e kam fjalën te fakti që, të gjithë ne shkrimtarët tjerë, bëjmë pjesë në një kontekst letrar i cili e prodhon Andreas Dushin. Gjithashtu, në anën tjetër, të gjithë shkrimtarët shqiptarë, përfshirë edhe ty, bëjnë pjesë në kontekstin letrar që më prodhon mua. Duket sikur së bashku e prodhojmë kontekstin, e pastaj ai na prodhon të gjithëve. Si mendon ti? Raporti i vezës me pulën?

Andreas Dushi: Ndryshe nga një pjesë e mirë e shkrimtarëve, ndoshta për shkak se jemi një letërsi e vogël, besoj se shkrimtarët shqiptarë kanë krijuar një rrjet mbështetës njëri për tjetrin. Ky rrjet – të cilin mund ta quajmë edhe kontekst, ndihmon përgjithësisht, secilin prej nesh. Aq më tepër, dikë që hy në letërsi "me këmbë të parë" si një i ri, akoma student ose i sapodiplomuar. Ndaj, jam thuajse i bindur se tërësia e shkrimtarëve shqiptarë ndihmon shkrimtarin si një i vetëm, edhe pse "shkrimësia" është thelbësisht individuale. E gjitha kjo, sigurisht nuk zbeh në asnjë çast rolin vendimtar të lexuesit, edhe pse unë mendoj se Eco ka të drejtë kur thotë që "Shkrimtarët e mirë duhet të shkruajnë, që të lexohen nga shkrimtarë të tjerë."

Më kujtohet një pjesë shumë interesante te "100 vjet vetmi" ku Kolonel Aureliano Buendia bënte cironka ari, pastaj i shkrinte dhe bënte të tjera, e kështu vriste kohën në vetminë absolute të pasluftës. Nuk e di përse, por pak a shumë kështu më duket çështja e shkrimtarëve dhe e

shkrimtarit. Konteksti i krijuar nga shkrimtarët, prodhon shkrimtarin i cili bëhet sërish pjesë e tij, në një rreth vicioz të pafundëm.
Ky rreth pastaj i paraqitet Lexuesit, Zotit të tekstit i cili e copëzon sipas shijeve të veta dhe merr atë çka Atij i duket më e përshtatshme.
Po ta shohim më konkretisht, sukseset ndërkombëtare të secilit prej nesh mendoj se kanë një lidhje. Shqipëria nuk ka fatin të njihet nga të huajt për shumëçka. Kur njëri prej nesh përkthehet në gjuhë të huaj, tjetri pas tij e ka pak më të thjeshtë krijimin e raportit me lexuesin e atij vendi.
Prandaj, tërësia e vlerave që autorët shqiptarë përfaqësojnë ka lidhje me suksesin e njërit syresh, ashtu sikurse suksesi i secilit, ka lidhje me tërësinë.
Të paktën, kështu e shoh unë. Po ti, si e mendon?

Azem Deliu: Po, besoj se ke të drejtë. Tani, po të bëj një pyetje direkte, dhe ndoshta që lidhet me faktorët jashtëletrarë: Si i mendon gjasat e letërsisë shqipe për një prezencë solide ndërkombëtare?
Andreas Dushi: Personalisht, jam i bindur se letërsia shqipe nuk ka asnjë arsye përse të ndihet inferiore përballë letërsive të tjera, por është e vërtetë se prezenca ndërkombëtare e saj lë për të dëshiruar. Mendoj se kjo nuk lidhet me faktorë letrarë. Ndoshta mungesa e politikave mbështetëse dhe promovuese jashtë shtetit është një arsye. Gjermania, për shembull, periodikisht ofron bursa dhe rezidenca për përkthyes nga gjuhë të ndryshme, të cilët përkthejnë në gjuhët e tyre letërsinë gjermane. Pra thënë shkoqur, në rrafshin letrar, letërsisë shqipe nuk i mungon asgjë. Në atë politik, po. Por jam shpresëplotë se e ardhmja do të jetë më e mirë. Krijimi i një qendre dedikuar librit më duket hap i hedhur në udhën e duhur.

Po ti, duke qenë se je i përkthyer në disa gjuhë, si e mendon këtë çështje? Si ka qenë përballja jote në "arenën ndërkombëtare"?

Azem Deliu: Ka qenë, aq sa mund të jetë, një "përballje" e mirë. Duke ulur pritshmëritë, e rrisim kënaqësinë. Në anën tjetër, pajtohem që, ndonëse vendosëm ta shpërfillnim politikën, do të qe mirë të organizoheshin politika kulturore si rezidencat, që e lehtësojnë përkthimin. Për ta përmbyllur, Andreas, çfarë po punon tani?

Andreas Dushi: Në fakt, po lexoj. Nuk jam duke punuar në diçka konkrete, por leximet i kam orientuar drejt një ideje akoma të vagullt. Se si apo kur mund të realizohet, s›di të them. Po ti? Ndonjë plan për të ardhmen?

Azem Deliu: Po e përmbyll këtë diskutim fort të këndshëm me ty, duke të treguar që në fakt e kam në dorë një roman. Nuk mund të them se kur do të dalë, por jam i bindur që nuk do të vonohet shumë. Kjo gjithsesi nënkupton, siç e di ti mjaft mirë, që leximet nuk ndalen asnjëherë. Shkrimi ndodh herë pas here, leximi duhet të ndodhë çdo ditë.

Andreas Dushi: Shumë kënaqësi Azem!



DE RADA – NJË PAMJE JOHISTORICISTE

nga Arben Veselaj

"Antitradicionalistët" e historisë së mendimit shqiptar ka kohë që po kërkojnë një rivlerësim të figurës së Jeronim De Radës brenda historisë së letërsisë shqiptare. Mbretëron mendimi se De Rada e meriton një vend tjetër, natyrisht shumë më të avancuar nga ai që e ka pasur deri më tani në studimet albanologjike.

Ata thonë se De Rada nuk duhet të shikohet e të vlerësohet vetëm si autori që i pari e promovoi traditën letrare moderne, por edhe si autor i një letërsie ku spikasin veçori moderniste letrare e filozofike. Ata kundërshtojnë tezën e "studiuesve tradicionalë" historiko-letrarë, të cilët, duke dashur që ta sforconin sa më tepër karakterin historicist të figurës së De Radës, i lanë në harresë vlerat estetike dhe filozofike të krijimtarisë së tij. Pra, duke dashur që t'i bëjnë një vend sa më të madh e më të nderuar në histori, e nxorën nga letërsia, dhe kjo, natyrisht, është e padrejtë.

Sidoqoftë, "antidracionalistët" dhe "tradicionalistët" megjithatë pajtohen se De Radës i takon statusi i themeluesit të letërsisë shqipe. Por si shtrohen këto kundërthënie në dritën e studimeve "jotradicionale" historiko-letrare?

Regjistri i gjatë bibliografik i librave që shkroi dhe botoi e bëjnë De Radën vërtetë një themelues të madh. Për nga vlerat e tyre të përgjithshme, asgjë mangut nga poemat e famshme të tij, nuk mbeten edhe shumë vepra të cilat rrallë janë trajtuar në studimet letrare shqiptare, si: katër novelat në vargje me titull "Rrëfimet e Arbrit", dy tragjeditë "Numidët" dhe "Sofonizma", eseja filozofike "Hyjnizme pellazgjike", studimet mbi historinë e gramatikës së gjuhës shqipe "Pellazgët dhe shqiptaret" dhe "Natyra e gjuhës shqipe", pastaj dy librat me karakter autobiografik "Testamenti politik" dhe "Autobiologjia" etj.

Qendra ku u formua si intelektual e shkrimtar - Napoli, flet për vetë fatin e veçantë të shkrimtarisë së De Radës. Në Napoli ai e krijoi botën letrare dhe brenda saj me shumë sukses arriti ta përfshijë traditën arbëreshe. Modeli letrar që krijoi qe krejtësisht origjinal, me parashenjat e qarta identitare. Me këtë ai pati sukses të jashtëzakonshëm pasi që u bë model për shumë autorë të tjerë arbëreshë (dhe për autorët shqiptarë në Atdhe) që erdhën pas tij.

Ndonëse bir-besnik i traditës letrare arbëreshe, idetë filozofike dhe politike të tij, janë, sot e këtu, po aq moderne sa të autorëve bashkëkohës italianë e francezë. Librat që shkroi dhe gazetat që botoi jo rrallë shkaktuan trazime jo vetëm shpirtërore-individuale por edhe politike-shoqërore. Ato kanë nxitur të bëma qytetarie, nxitje masash, rebelim qytetar etj.

I frymëzuar nga shembulli i autorëve më të shquar italianë të kohës së Risorgimento-s (Rilindjes) italiane, edhe De Rada krijimtarisë së tij i dha karakter utilitarist duke e vënë atë në shërbim të Rilindjes Kombëtare Shqiptare që synonte rikrijimin e shtetit shqiptar mbi trashëgiminë skënderbegiane. Por ky utilitarizëm nuk ia zbeh aspak vlerat estetike dhe universale që kanë veprat e tij letrare.

De Rada ishte shkrimtar në kuptimin më të saktë të fjalës. Ai e përjetoi edhe fatin e shkrimtarit të ndaluar. Për shkak të ideve iu censuruan dhe iu ndaluan disa libra. Poema "Këngët e Serafina Topisë" iu ndalua në Napoli më 1840 nga autoritetet që kontrolloheshin prej burbonistëve, pasi që më tepër sesa një poemë dashurie kjo vepër ishte një kushtrim për bashkimin e kombit shqiptar.

Letërsia shqipe do të ishte shumë e varfër pa këtë poemë madhështore. Zor se mund të gjendet një vepër tjetër ku kaq mjeshtërisht dhe me kaq ndjeshmëri shkrihen dy temat e mëdha të letërsisë: dashuria dhe atdheu. Me shumë të drejtë disa studiues e kanë vlerësuar si "shekspirian" subjektin e kësaj poeme, ndërsa heronjtë e saj, Serafinën dhe Bozdar Stresin, si Xhulietën dhe Romeon shqiptar. Një dashuri e madhe me gjak mbretëror vetësakrifikohet në altarin e bashkimit të kombit arbëror, bashkimit të Jugut me Veriun, të Toskërisë me Gegninë.

De Rada është i pari autor shqiptar që çeli portën e madhe të romantizmit evropian. Poema e tij e famshme "Këngët e Milosaos" (1836) nuk është vetëm paradigmë e letërsisë romantike shqiptare, por edhe një vepër që qëndron lart si një shenjë e dukshme brenda universit të romantizmit evropian. Për këtë vepër ai pati një përkujdesje gjatë gjithë jetës; pati një dashuri të veçantë për të, sepse ishte i vetëdijshëm se kishte shkruar një kryevepër. Poema "Këngët e Milosaos" për herë të parë e bën gjuhën shqipe gjuhë të letërsisë.

Më shumë se tek të gjitha veprat e tjera, tek Milosao, De Rada me mjeshtri të pangjashme arrin t'i pleksë dhe t'i shkrijë artistikisht idetë kombëtare me ato universale. Sigurisht, e frymëzuar nga tradita e një letërsie shumë të pasur orale arbëreshe, kjo poemë është dhe një monument përmes së cilës ai e ndërton "mitin" për të kaluarën heroike të popullit të tij, për vendlindjen e braktisur të të parëve të tij etj.

Është edhe një vepër tjetër e De Radës, "Rapsodi të një poeme arbëreshe", që pret një rivlerësim të ri nga studiuesit dhe kritikët. Kjo vepër paraqet njërën nga kryeveprat e letërsisë shqipe në të cilën përmblidhen disa nga perlat më të çmuara të trashëgimisë së epikës sonë, ndoshta që nga kohët homerike. Ky libër, sa i veçantë, po aq dhe me vlerë, nuk është veç një përmbledhje këngësh të epikës popullore, por meqenëse u rishkrua nga pena e një poeti të madh, merr një tjetër kualitet dhe ngrihet në letërsi të madhe.

"Rapsodi të një poeme arbëreshe" paraqet njërin nga dokumentet e pakta letrare ku lidhet tradita letrare orale me atë të shkruar. Pra, me këtë libër epika e traditës orale arbëreshe bëhet letërsi e shkruar. Studiuesit "tradicionalë" shqiptarë duke e kualifikuar këtë si një vepër me rëndësi "historike" kanë bërë që ajo të hiqet nga vëmendja dhe interesimi i lexuesve për ta lexuar si letërsi të pastër.

Brenda kësaj përmbledhjeje gëlojnë perlat më të bukura të epikës arbërore të shekullit XV. Në këngët e kësaj përmbledhjeje, të cilat De Rada i quan rapsodi, bota shqiptare është një botë roajaliste (mbretërore), gjuha shqipe bëhet gjuhë e letërsisë kalorësiake.

De Rada e shkroi edhe traktatin e mendimit kritik dhe estetik të romantizmit shqiptar, "Parime të estetikës" (Principi di estetica), të cilën e botoi në vitin 1861. Përmes një shkrimi eseistik ai na ka parashtruar një lëndë studimore që ka të bëjë me njohjen dhe përjetimin e së bukurës, me pragmatizmin dhe utilitarizmin e saj. Krijimtarisë së tij letrare ai sikur dëshironte t'ia vinte si parashenjë edhe argumentin shkencor.

Kjo vepër shpalos çështje të brendshme të njeriut, duke u ndalur sidomos tek zhvillimi i mendimit dhe ndjenjave estetike. Njeriu dhe bukuria e tij, në njërën anë, dhe njeriu dhe vetëdija e tij, në anën tjetër, janë objekte të konceptit estetik të De Radës. Estetika e De Radës nënkuptohet në dy kategori themelore: ideali për të bukurën dhe ideali për atdheun. Pra, ideali (dashuria) për atdheun për De Radën është një kategori estetike.

Mbi këto parime ai e ka përkufizuar lëndën e estetikës së tij, si teori mbi të bukurën. Ai thotë se bukuria qëndron vetëm në shpirtin e njeriut. Siç duket, të bukurën letrare që e pasqyroi në veprat e tij, ai "duhej" me doemos ta dëshmonte edhe me argumentet e së vërtetës shkencore. De Rada mendonte se asgjë e bukur nuk mund të ishte e tillë nëse nuk ishte edhe e vërtetë.

"Parime të estetikës" dëshmon jo vetëm për fillet e mendimit kritik dhe estetik brenda ndërgjegjes kulturore dhe kombëtare shqiptare, por edhe për kulturën dhe dijen e lartë që kishte De Rada. Me këtë vepër ai e radhiti kulturën dhe dijen kombëtare shqiptare krah kulturave dhe dijeve më të avancuara evropiane të kohës.

Në një ligjëratë që kishte mbajtur në vitin 2014 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në Tiranë, kur po mbahej një konferencë për nder të 200-vjetorit të lindjes së De Radës, profesori i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Palermos, Matteo Mandalà, me një ton të ashpër kishte polemizuar me të gjithë ata që thoshin se poezia e De Radës është problematike për t'u kuptuar. Sipas Mandalàsë, poezia e De Radës nuk është aspak problematike, por janë kritikët dhe studiuesit letrarë ata që nuk e kanë nivelin mjaftueshëm të lartë për ta kuptuar letërsinë e tij.

Siç duket zëri i Mandalàsë do të mbetet i vetmuar, sepse mbi shkencat albanologjike ende po vazhdon ndikimi doktrinar historicist i shkollave shqiptare të realsocializmit.

SI TA SHKRUEJ QYTETIN?
RASTI I SHKODRËS

nga Ardian Ndreca

Qyteti shkruhet me arkitekturë dhe me urbanistikë, me ide, me njerëz, me histori, ai asht fryt i nji kulture dhe reflekton kulturën që e ka krijue. Shkodra nuk ban përjashtim edhe pse gjithnji e ma shumë arsyeja me u krenue me të mbrapavendoset në kohë.

Nji prej mënyrave për me shkrue qytetin asht edhe nëpërmjet odonimeve, bahet fjalë për emnat e rrugëve. Gjithmonë dhe gjithkund odonimet kanë qenë dhe janë të lidhuna me ideologjitë dhe me pushtetin.

Megjithatë nji odonomastikë e qëndrueshme asht shenjë kulture dhe tregon se ai qytet, ose ma mirë ai qytetnim, ka mbërrijtë nji ekuilibër të atillë që sido të ndryshojë pushteti nuk ndërron emnat e rrugëve krye tri dekadash.

Mendoni sa e sa rrugë në Romë, Madrid, Venedik, Paris, Vjenë që mbajnë po ato emna prej katër-pesë shekujsh. Ndokush do të ketë provue madje kënaqësinë që tue vizitue këto qytete me gjetë nji rrugë që shekuj ma parë asht përshkrue në nji roman, në nji libër historie, apo që përmendet në nji ngjarje me randësi. Tek ne ma shpesh na ka ra me provue zhgënjimin e humbjes së çdo gjurme, pse shumë shpesh ne harrojmë, shlyejmë e çdo herë nisim rishtas prej te abetarja. Tek ne veç qielli me yje vijon me qenë i njejti, pse poshtë bajmë lesh e li gjithçka që kena në dorë.

Tue pa disa harta topografike të Shkodrës e ma ekzaktsisht atë të vitit 1913 të kohës së Internacionalit, atë të vitit 1923 të Etënve Jezuitë, atë të vitit 1940 të kohës së fashizmit dhe atë të viteve ’70, pra të kohës së komunizmit, mund të dallojmë lehtësisht luftën për kontrollin e hapsinës urbane nëpërmjet odonomastikës.

Ajo e vitit 1913, e para në llojin e saj, paraqet vullnetin sundimtar të pranisë ushtarake të Fuqive të Mëdhaja në Shkodër, dhe nuk len hapsinë për asnji emën shqiptar. Ajo e vitit 1923 reflekton bindjet e reja që buronin prej shtetit të sapothemeluem shqiptar, fryt i Rilindjes sonë kombëtare. Kurse harta e kohës së fashizmit, tue pasë parasysh se asokohe ishim pa sovranitet, mund të themi se respektonte admirueshëm odonomastikën e maparshme, kuptohet tue e mëlmye me ndonji emën-simbol të fashizmit. Ndërsa harta e kohës së komunizmit solli ndryshime rranjësore, tue mos respektue asnji traditë dhe emërtim historik, por tue e mbushë qytetin me emnat dhe datat e atyne që kishin marrë në dorë pushtetin në vitin 1944.

Asht me interesë me vërejt sesi në gadi tetë dekada - që për nji qytet si Shkodra nuk janë shumë - kanë ndrrue deri në pesë herë emnat e rrugëve siç mund të shihet edhe prej kësaj tabele:

Përfytyroni njerëz që kanë lindë në Rrugën d’Estournelles de Constant, janë burrnue në Rrugën Enver Hoxha dhe kanë vdekë në Rrugën Vilson! Ndoshta të kishin pritë edhe pak do të kishin pasë fatin me vdekë në Rrugën Nard Ndoka!

Në kohën e komunizmit të gjitha rrugët e hapuna rishtas merrnin emna që kishin lidhje me regjimin në fuqi, për shembull bulevardi që bashkoi Fushë Qelën me Azilin e Qelës, pjesa nga qendra e qytetit tek ish Dega, u quejt Bulevardi Stalin, ndërsa sot quhet Bulevardi Skënderbeu. Kudo kishte emna atentatorësh, veprimtarësh të lidhun me “Lëvizjen”, për shumicën e të cilëve në nivel vetëdije qytetare nuk njihej pothuejse asgja,



1913	1923	1940	1945-1990	2020
Rue International	Udha e Madhe dhe Rruga e Parrucës	Udha e Madhe dhe Rruga e Parrucës	Rr. Shyqyri Bushati dhe Rr. Vasil Shanto	Bulevardi Zog I
Rue Jules Michelet	Rr. e Teutës	Rr. e Mbretneshës Teutë	Rr. Lidhja e Prizrenit	Rr. Lidhja e Prizrenit
Rue Ferrucio	Rr. Skanderbeg	Rr. Skanderbeg	Rr. Alqi Kondi + Rr. e Hotel Sportit + Rr. Skanderbeg	Rr. Mehmet Pashë Plaku + Rr. Edith Durham + Rr. Marin Beçikemi
Place Radetzky			Sheshi Isa Boletini	Sheshi Perash
Rue Varese	Rr. e Gurakuqve	Rr. e Gurakuqve	Rr. e Gurakuqve	Rr. e Gurakuqve
Rue Franz Ferdinand	Rr. J. Godard dhe Rr. e Serreqit	Rr. J. Godard dhe Rr. e Serreqit	Rr. Branko Kadia dhe Rr. Justin Godard	Rr. Gjuhadol dhe Rr. Justin Godard
Place Jean d'Arc	Sheshi i Xhamisë Kiras			Sheshi Kiras
Rue Victor Hugo	Rr. e Kirasit		Rr. Perlat Rexhepi	Rr. Hoxha Tahsin
Impasse Climene	Rr. Ndojej	Rr. Ndojej	Rr. Aleksander Moisiu	Rr. Loro Kovaçi
Rue Piemonte	Rr. Canej		Rr. Ton Alimhilli	Rr. Lin Delija
Rue du Consulat du France	Rr. e d'Estournelles	Rr. e d'Estournelles	Rr. Enver Hoxha	Rr. Vilson
Rue du Consulat d'Italie	Rr. e Spitalit		Rr. Migjeni	Rr. Don Bosko
Rue Radetzky	Rr. e Arrës së Madhe	Rr. e Arrës së Madhe	Rr. Kongresi i Lushnjes	Rr. Arra e Madhe
Rue St. Bon	Rr. e Badrave	Rr. e Badrave	Rr. Bardhok Biba	Rr. Ludovik Saraçi
Rue International	Udha e Madhe	Udha e Madhe	Rr. Daniel Matlia	Rr. Kardinal Mikel Koliqi
Rue Internationale	Rr. 28 Nanduer dhe pjesërisht Rr. e Madhe	Rr. Viktor Emanueli II		Rr. 28 Nandori
Rue Jules Ferry	Udha e Dukagjinit	Rr. e Dukagjnit	Rr. Musa Luli	Rr. Myzafer Pipa
Rue Goeben	Rr. e Dervish Begut	Rr. e Dervish Begut	Rr. Hajrulla Kastrati ma vonë Rr. 4 Qershori	Rr. Hafiz Sabri Boriçi + Rr. Daut Boriçi
Rue Victoria Louise	Rr. 28 Nandor		Rr. Jorgji Karamitri	Rr. Besnik Sykja

as se çka kishin ba dhe as si kishin vdekë.

Kjo s'do të thotë se Shkodra s'duhet me pasë rrugë që të mbajnë emnat e të ramëve të Luftës së Dytë botnore. Për shembull dëshmorit Reshit Rusi, pinjoll i nji familjes së nderueme qytetare dhe ish nxanës i liceut *Illyricum*, i asht kushtue *stadiumi* tek ish Fusha e Lëkurave. Të njejtën gja e meritojnë edhe anëtarë tjerë të asaj *lëvizje* si Zef Mala, Qemal Stafa, Selim Shpuza, Fadil Paçrami etj.

Do të kishte qenë logjike që koha e demokracisë të kishte gjetë rrugëzgjidhje për shumë padrejtësina historike, por fatkeqsia e atij qyteti me qenë pothuejse gjithnji i drejtuem prej individësh pa spesor moral dhe intelektual dhe kthimi i idealeve demokratike në ideologji të mirëfilltë ku ka mbizotnue dialektika mik/anmik, ka krijue nji katrahurë në qytet.

Sot do të gjeni rrugë me emna qesharakë dhe të pakuptimtë si: Rruga Rinia, Rruga Treni i Mallrave, Rruga e Mëndafshit, Rruga Kumbulla e Vardilave, apo rrugë me emna njerzish për të cilët lodheni kot me gjetë ndonji informacion historik që të justifikojë kilometrat linearë që u janë kushtue: Rruga Ludovik Saraçi, Rruga Shaqir Oso Zeqja, Rruga Rozar Dodmasej, Rruga Todi Gërmenji! Tek ne nuk ndahen vetëm tenderat por edhe rrugët dhe emnat e të vdekunve që duhet me ua kushtue!

Klientelizmit, tarafeve, partizanllekut i asht shtue ndonjiherë edhe mungesa e elegancës. Profesor Sami Repishti patjetër që e meriton nji rrugë në vendlindje e madje meriton edhe shumë ma tepër për aktivitetin e tij prej disa dekadash në favor të vendit tonë, por profesori i nderuem asht gjallë e shëndosh dhe zakoni i marrë me i dhanë nji rruge emnin e nji personi që ende s'e ka mbyllë shtegtimin toksor nuk ndeshet vetëm në Kamzë, e cila siç dihet rrezaton dije dhe qytetni, por edhe në Shkodër. Nji gja e tillë shërben vetëm me e vu në pozitë jo komode të interesuemin, sidomos kur asht i stolisun me cilsina të nalta si profesori në fjalë.

Po të flasim për mungesat s'do të mbaronim kurrë, por po përmendi sa për shembull vetëm disa emna që do ta kishin meritue me ia pasë kushtue nji rrugë në Shkodër. Po e nisi me disa pararendës që e meritojnë për kontributin e madh dhe lidhjet që kanë pasë me kryeqendrën veriore, siç asht rasti i Anton Loredanit, kapiten dhe mbrojtës i Shkodrës, *Maestro* Giovanni Canale, themelues i bandës së qytetit në vitin 1878, mjekët humanista Gennaro Simini dhe Basri Qallimi, apo rasti i Dr. Xhevat Korçës, drejtori i parë i Gjimnazit Shtetnor.

Vijnë mandej me rradhë shkrimtarë, intelektualë, njerëz të kulturës dhe veprimtarë si Ndoc Nikaj, Lazër Shantoja, Migjeni, Zef Mala, Llukë Karafili, Arshi Pipa, Veli Stafa, Zef Zorba, Frederik Rreshpja, Safete Sofia Juka, Ferdinand Paci, Rini Monajka.

Ndër të gjithë këto emna asht paradigmatik rasti i dom Ndoc Nikajt, të cilit, edhe pse klerik i dënuem, në kohë të komunizmit emnin e tij e mbante nji rrugë, ndërsa menjiherë mbas ramjes së regjimit emni iu zëvendësue me nji tjetër. Bashkia e Shkodrës dhe këshilltarët e saj, njerëz me komplekse dhe pa guxim qytetar, s'kanë pasë aq integritet sa me ia dhanë emnin e Át Anton Harapit nji rruge urbane por e kanë degdisë në nji shpat të Taraboshit, te Kazena, për ma tepër mbrenda nji hapsine private. E kanë pasë ma kollaj me i mbushë rrugët e qytetit me emna *deng pa markë*, pse ashtu kanë kënaqë njeni-tjetrin dhe s'kanë "rrezikue" asgja. Por sado që t'i jepni rrugëve emnat e tekahytave të partisë në pushtet, apo të afërmve e farefisëve tuej, lodheni kot, pse ata që s'kanë pasë vlerë në të gjallë nuk marrin vlerë për së vdekuni!

Në fund krejt do të doja shumë që të dilte dikush e të më përgënjeshtronte tue më tregue se ku janë rrugët që i kushtohen Ndoc Nikajt, Shantojës, Arshi Pipës, Zef Zorbës, Frederik Rreshpjes!!

Raste për t'u trajtue në vete janë edhe gabimet drejtshkrimore. Tue qenë se administrata shtetnore duhet ta pranojë Drejtshkrimin e vitit 1972, kjo gja do të ishte dashtë me u pasqyrue edhe në odonomastikën urbane.

Mjerisht shihen shëmtime gjuhësore, fryte të nji pseudo-gegnishteje prej analfabetësh, si psh. Rruga Baja e Vogël apo Rruga At Gjergj Fishta! Në gjuhën shqipe nuk thuhet "At filani": o duhet *Át* (gegnisht) ose ma mirë *Atë*. Sigurisht nuk mund të ndiqet me sy mbyllë as drejtshkrimi i masipërm kur bahet fjalë për shkrimin e emnave të huej, sidomos kur rezultati asht: Rruga Gjino Berri apo Rruga Zhasin Hekard! Ma e pakta do të duhej që në kllapa të vendosej emni siç e ka shkrue vetë mbajtësi: Hyacinthe Louis Hecquard tue shtue transkriptimin e saktë shqip, profesionin dhe datat e lindjes dhe të vdekjes.

Odonomastika urbane mundet me qenë dije dhe kulturë për të gjithë.

Mund të konstatohet lehtë sesi nji qytet si Shkodra ka pasë ma shumë *vende* kuptimplote me forcë simbolike në vitin 1940 sesa sot që edhe pse asht qindfishue repertori urban, për me postue nji letër duhet të vendosësh në kllapa: afër Telekomit, tek Dollari, mbas hotel filanit, tek pallatet e filan fistekut, te Western Unioni e të dhana tjera qesharake.

Hapsina urbane që kena krijue nuk qëndron në kambët e veta. Sidomos ajo e ndërtuemja në dekadat e fundit asht e pakuptimtë, pse s'mjafton betoni me ba qytete, *kullat janë protezat e nji qyteti pa gjymtyrë* e kjo vlen kryekreje për Tiranën.

Në lidhje me odonomastikën ka vite që kambëngulim, së bashku me disa miq, edhe me anë peticionesh, për me ba diçka që inercia e të quejtunit "djep i kulturës" të marrin nji kuptim ma aktual për Shkodrën. Mjerisht dy kryetarët e fundit të bashkisë kanë qenë totalisht indiferentë. I jam drejtue edhe disa deputetëve shkodranë, fillimisht të djathtë e së fundi edhe nji deputetes së majtë, por e kam të qartë se këto s'janë *halle* deputetësh.

Më bjen ndër mend ajo çka shkruente Lazër Shantoja këtu e gadi nji shekull ma parë: *ju deputetët e Shqipnisë jeni samarxhitë e popullit*!

E sotmja i ka të gjitha veset e kohës kur shkruente Shantoja, por mjerisht nuk ka asnji prej virtyteve që kishte ajo, e atëherë në këtë shkretinë ku jena, me u marrë me emna rrugësh asht njilloj si me u mundue me shkrue kodin penal në ranë!

LIBRI I PASKAJORES

tregim nga

Granit Zela

Gjykata Popullore shpalli me bujë dënimin me vdekje të paskajores. Kjo përkoi me dënimin me vdekje të Pjetër Mëshkalla i cili qe krejt ndryshe nga të gjitha dëminet që u hanë për përdoruesit e paskajores pas ndalimit të saj e ligj. Sikurse thuhet në Kodin e Republikës Popullore "Gjykatat popullore janë organet që realizojnë dhënien e drejtësisë", prandaj dhe ky dënim me vdekje tregoi që "drejtësia vonon por të dënon." Dënimi i paskajores ndodhi pas disa dekadash hetimesh nga organet e ruajtjes së redit publik, dekada gjatë të cilëve u bë e qartë si drita e diellit se personat që përdornin paskajoren ishim shumë të rrezikshëm për rendin juridik.

Qysh mbas vendosjes së rendit të ri në vendin tonë u zbuluan shumë armiq në veri të vendit që ia donin jetën e shkurtër regjimit të tyre popullor. Shteti i Ri i bënte përditë thirrje popullit që të ishte vigjilent dhe të mos lejonte që në të folurën e tij të përditshme të depërtonte paskajorja qoftë edhe në mënyrë të pavetëdijshme. Nëse ndokush përdorte paskajoren ai duhej që menjëherë të denoncohej në organet e ruajtjes së Rendit. Kjo u bë e detyrueshme sidomos pas shpalljes së programit të Qeverisë së Re, ku deklarohej se synimi kryesor i qeverisë në pesëvjeçarin e ardhshëm ishte çrrënjosja e paskajores nga gjuha e të gjithë shtetasve duke pasur objektiv afat-mesëm zhdukjene saj nga gjuha e shkruar brenda pesë vjetëve tek të gjithë shtetasit pa dallim feje, krahine, ideje dhe dëbimin e paskajores nga gjuha e folur një herë e përgjithmonë brenda dhjetë vjetësh. Pas kësaj, në Kodin Themeltar të Republikës u saknsionua "Në vendin tonë përdoruesit e paskajores dënohen me vdekje".

Gjatë kësaj kohe, në çdo shkollë të vendit u dogjën të gjitha librat e shkruar që përdornin paskajoren, u dënuan me gjyqe të hapur shumë grupe individësh që e përdornin në mënyrë të feshtë në familjet e tyre ndërkohë që Shtetit të Ri i betoheshin për besnikëri dhe respektim të zbatimit të ligjshmërisë. Masat punonjëse u angazhuan në shkrimin e shumë parrullave kudo ku kishte faqe mali, mure ndërtese apo qoftë edhe në lëvore drurësh parrullat e madhërishme si:

"*Lumi fle, paskajorja nuk fle*",

"*Mospërdorimi i paskajores është plumb për armikun*",

"*Ta përdorim gjuhën pa paskajore*",

"*Lart frymën revolucionare në luftë kundër paskajores*",

"*Paskajorja bashkëpunon me armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, kërcënon qenien tonë si komb, është kundër pavarësisë tonë kombëtare, helmon gjuhën tonë amtare dhe lufton kundër drejtësisë shoqërore*".

Nga të gjitha parrullat që u shkruan kudo e kurdo shumica e tyre dolën prej fjalimeve të Udhëheqësit të Ndritur. Në një farë mënyre të gjithë paragrafët ku ai përmendte paskajoren u shndërruan në fjali ndriçuese për mendjen e qindra mijëra njerëzve anemabanë vendit tonë. Sipas Udhëheqësit të Ndritur paskajorja ishte armikja më e egër e Revolucionit të Madh, me përhapjen e ideve paskajoriste (pra, për përdorimin nga populli të paskajores), duke synuar që të përmbysë fatet e popullit tonë për ta nënshtruar për shekuj të tërë robërie.

Prandaj, edhe popullit i kërkohej të ngrihej në këmbë kundër paskajores, në Frontin Paskajore çlirimtare dhe të hidhet me armë në dorë në luftën më të madhe të historisë së tij për çlirimin kombëtar dhe shoqëror nga zgjedha e paskajores. Në zjarrin e luftës kundër paskajores, mbi gërmadhat e saj, do të ngrihej një gjuhë e re, gjuhë e cila do të merrte në dorë fatet e saj. Ishte paskajorja ajo që kishte ndikuar në të shkuarën në grabitjen e pasurisë vendit. Tani paskajorja do të shfronësohej duke i hapur udhë kolektivizimit të të gjitha mjeteve të gjuhës shqipe në epokën e re paspaskajores.

U likuidua paskajorja si instrument gjuhësor që i pinte gjakun përcjellores, sundonte me mizori parafjalën, shtypte dhe u jipte dërrmën emrave, mbiemrave, foljeve dhe ndajfoljeve duke i shfrytëzuar ato në shërbim të interesave të saj të errëta. Vetëm me dënimin me vdekje të paskajores pati një çlirim të forcave të gjalla të fjalive të të gjitha llojeve, qofshin ato dëftore, dëftore-thirrmore, dëshirore e nxitëse, fjalive pyetëse por mbi të gjitha pati një ripërtëritje të dukshme të fjalive pohore dhe mohore, ndërkohë që kudroherë që bëhej fjalë për paskajoren mohimi ishte kategorik.

Të gjitha mjetet e gjuhës, pas shuarjes së paskajores një herë e përgjithmonë nga gjuha jonë, treguan epërsinë e tyre të padiskutueshme në të gjitha fushat e shprehjes, në procesin e pandërprerë të revolucionarizimit të gjuhës, duke u kthyer në një forcë të madhe gjuhësore të shkonte drejt emnacipimit të saj të plotë. Në këtë mënyrë u shembën bazat e obskurantizmit gjuhësor të paskajores. I gjithë ky proces historik kulmoi me ekzekutimin një për një të të gjitha paskajoreve, dënimin e atyre që i përdorën ato pas ndalimit me ligj. Ndër të gjithë të dënuarit e atyre vale gjyqesh popullore, internimesh dhe persekutimesh ishte edhe Pjetër Mëshkalla, një shkrimtar nga Shkodra i cili menjëherë pas ndalimit të paskajores me ligj u bë memec, dhe nuk tha asnjë fjalë. Organet e pushtetit popullor zbuluan tek kjo heshtje, kjo memecëri një komplot të rrezikshëm, një lloj kryengritje ndaj regjimit popullor.

Pjetër Mëshkalla ishte një shkrimtar i njohur në qarkun e veriut por mospranimi i tij për të shkruar dhe për të folur u interpretua si protestë e hapur në mbështetje të paskajores, dhe kësisoj ai u kthye në të dënuarin e parë që u burgos se pse nuk e kishte

përdorur paskajoren, ndërkohë që qindra të tjerë qenë dënuar se e kishin përdorur. Dosja hetimore e shkrimtarit Pjetër Mëshkalla Mëshkalla përcoll deri në nivelet më të larta shtetërore. Ç'ishte ky shkrimtar me heshtje të rrezikshme? Cili ishte ndikimi i këdaj heshtje në shkrimin fshehtas të paskajores dhe fshehjen apo asgjësimin e dorëshkrimeve apo letrave ku ajo përdorej? Cila ishte lidhja mes heshtjes së këtij shkrimtari dhe përhapjes së krimit politik? Hetimet vazhduan me një ritëm shumë të dendur ku u përfshinë dhjetëra të njohur dhe të panjohur prej tij, derisa më së fundi u rindërtua krejt ajo që kishte ndodhur me këtë shkrimtar të cilën po e rrëfejmë këtu.

Ishte viti 1976. Qysh në janar të atij viti Pjetër Mëshkalla, shkrimtar i vetmuar (thuhej se kishte një vëlla në një qytet në jug të vendit, një vëlla binjak që ishte edhe ai shkrimtar, por që nuk dinte kurrgjë për ekzistencën e tij) pati shenja të çuditshme që nuk i kishte pasur kurrë më parë' nisi të fliste si në jerm fjalë që atëherë askush nuk ua kishte vënë veshin, fjalë që tingëllonin të zakonshme por që gjatë hetimit dolën se kishin qenë paskajore. Pas pyetjes për të disatën herë të të gjithë individëve që kishin pasur të bënin me të dhe u arrit në përfundimin që në janar të atij viti si përsëriste pa pushim paskajore që fillonin me shkronjën "a", madje me radhë në secilin muaj .

Çohej si lugat natën duke folur si në jerm, a thuase fliste me njerëz të një bote tjetër apo po thoshte me zë fjalët e një lutje të gjatë që nuk mbaronte kurrë ndërsa përsëriste pa pushim si i lojtur paskajore. Pas konfiskimit të dorëshkrimeve të tij u ngrit një Komision I Hulumtitmit të Veprimtarisë së Rrezikshme në Gjuhësi i cilli arriti hartoi një listë të paskajoreve që Pjetër Mëshkalla kishte përdorur në dorëshkrimet e tij.

Fakti që dikur Pjetër Mëshkalla kishte qenë prift, bëri që njerëzit të mendonin se ai po thoshte lutje që dikur i thoshte në kishë, ishte një zakon i vjetër që i qe ringjallur ndaj dhe kalonin pa u marrë me të. Të gjitha paskajoret që ai kishte shqiptuar gjatë janarit u gjetën në një libër me titull "Libri i Paskajoreve" të cilin ai e mbante me vete ngado që shkonte por që njerëzit mendonin se qe një libër kishtar që ai harronte dhe e merrte ngado që shkonte edhe pse e dinte fort mirë se kjo nuk lejohej. Por ai ishte i shkuar në moshë dhe njerëzit i ndihmonte ky fakt që të mos merreshin me të. Mungesa e vigjilencës për këtë jerm gjuhësor që në të vërtetë sikur vërtetuan edhe dëshmitë e mëvonshme ishte burimi i një kryengritje të rrezikshmërisë në mbështetje të paskajores dhe në këtë mënyrë i vinte kazmën pushtetit popullor që kishte dalë nga gryka e pushkës.

Në muajin shkurt Pjetër Mëshkalla nuk u pa të fliste apo më mirë të thuash të mërmëriste ngado që shkonte si i marrë kjo ngase shumë më pas u mor vesh që ai pëshpëriste me vete nga një paskajore për cdo gërmë të alfabetit, si një lloj lutjeje që përcillte një kumt të pakuptueshëm me të cilin u morën organet e pushtetit. Pas një "kuvendimi" të gjatë në qelitë e atdheut tonë, organet kompetente arritën në përfundimin që i akuzuari kishte përmendë gjatë kësaj kohe më së shumti paskajoret.

Provat që u gjetën në magnetefon rënduan dosjen e Pjetër Mëshkalla Mëshkallës. Ato ishin prova të pakundërshtueshme. Zëri i rregjistruar, mënyra e shqiptimit gati me adhurim i atyre fjalëve ishte në kundërshtim të hapur madje sfidë që i bëhej adhurimit që kishte populli ndaj Udhëheqësit të Ndritur. Si guxonte ai të shprehte një dashuri të tillë që mund të shprehej vetëm për Udhëheqësin tonë legjendar?

Ditën e ekzekutimit të tij publik, Pjetër Mëshkalla u vendos në një turrë librash në sheshin e qytetit. Pak para se zjarri t'u vihej atyre librave ishte pyetur për fjalën e fundit dhe ai kishte thënë "me dashunue, me dashunue, me dashunue" ndërsa kishte pritur që zjarri i shkronjave, fjalëve, paragrafëve, fjalive, kapitujve, prologëve, dialogëve, monologëve dhe epilogëve duke ia ngrohur shpirtin për me ia çue mandej në parriz. Turma brohoriti e gëzueme.

UNË DHE VAJZA NGA DIMENSIONI TJETËR

tregim nga

Ismet Aliu

Dhe, të dy u gjendëm në një dimension tjetër. As i imi as i yti. Dimension ku takohen dy të djeshme që ëndrra u ka mbetur në gjysmë."

Ishte e diel...

Orari i lëvizjes sime ishte nga 9.00 deri në 10.30. Shkova te vila me nxitim, ku kisha edhe një kopsht me pemë thuaja se nga të gjitha llojet. Ndoshta nga që biçikletën e ngisja shpejt, kur arrita ndjeva se isha lodhur shumë. Mbaj mend se kam qenë në një gjendje të shpjegueshme shpirtërore. Më kujtohet se gjatë rrugës e kam parë një Vajzë që s'ishte as e kësaj kohe as e kësaj bote. Kjo ka qenë sall një çast: si vetëtima. Nuk e di pse ai çast nuk më ka habitur. Më bëhet se edhe unë me pjesën time shpirtërore kam qenë diku gjetkë.

Ajo ka shëtitur nëpër mendjen time me pastërtinë e gurrës, me të cilën mjaftohemi vetëm duke e shikuar...

Disi i dyzuar, si ndarë në fragmente kohësh, arrita te vila. Nga lodhja e tepërt, derisa po i shikoja pemët e harlisura në lulëzim, (pemët s' më ngjanin në ato të kopshtit tim) mbase më kishte kotur gjumi. Ndoshta do të kem fjetur pak minuta. Kushedi?! Tek i shikoja pemët, prapë po them, s'di të kem qenë fjetur a zgjuar, s'di ç'më ngjau, por e di se u shndërrova në dru molle. Ato, çaste mbase kam qenë pema e mollës më të çuditshme në gjithë planetin, meqë jo vetëm që isha pemë, por e ndjeja se jam pemë. Ndjeja gjithçka, megjithatë nuk mund të shprehja asgjë. Koha rridhte pa praninë time si qenie njerëzore... Këtu koha kishte kuptim jashtë planetar. Ishte një kohë kozmike nuk di e ardhur prej kah. Ndoshta këtu kjo kohë nuk e kishte kuptimin si në dimensionin prej nga kishte ardhur. Kushedi?! Trupit tim, që tani ishte pemë, i ranë lulet. Në vend të luleve nisën mollët. Isha pema që i shihte frutat e saj sesi rriteshin. Njëkohësisht rriteshin frutat, degët, gjethet. Ishte një harlisje. Ndërkohë nisi të bjerë shi. Piva ujë nga krojet e Zotit dhe ndjeva veten edhe më të fuqishëm. Më vonë ra një mjegull e bardhë, e dendur, e paqartë... Aq e dendur sa nuk e shihja veten. Degët plot fruta molle, rriteshin e rriteshin, sikur donin të dilnin tej mjegulle. Edhe pse s' pashë gjë, ndjeva gishtërinjtë skofiarë të një dore të butë që po e shkulnin nga trupi im një mollë. Tek e shkulnin frutin e mollës, ndjeja dhimbje. Ajo kapi degën. Dega tash ishte tej mjegulle. Ajo kishte tërhequr trupin tim dhe sakaq u gjenda pranë saj. Vajza po hante mollë. Shikova orën. Ora ishte dhjetë. Kisha kohë edhe 30 minuta. Peizazhi ishte mahnitës. Gjithçka lahej në dritën mahnitëse të një dielli që buzëqeshte nga të gjitha anët. Një peizazh i çuditshëm, me një hapësirë të pafund, e në gjithë atë hapësirë një vajzë. Desh harrova: isha edhe unë. Po, po... Edhe unë do të kem qenë aty...

"Kush je ti", e pyeta

"Unë?! -qeshi... -S' më njeh?!"

" Jo, s'jam i sigurt, jo...", i thashë me mëdyshje. Ajo qeshi . "hi, hi, hi, hi!", sa gjithë ajo hapësirë trishtuese kumboi si një përmbysje e largët, diku tej këtij çasti. Pasi e shikova mirë, por prapë me mëdyshje, i thashë: " Më bëhet se gjithmonë disi të kam njohur..." Ajo përsëri qeshi: "Hi, hi, hi, hi!", dhe përsëri nga e qeshura e saj u trand i gjithë peizazhi.

"Kujtohu edhe një herë!", më tha. Unë s' thashë gjë, veçse ndjeva si nëpër mjegull se ata sy dikur më kishin bërë pafundësisht të lumtur. Tek e shikoja në sy, ndjeva se edhe ajo ndjente dhimbje. Pas pak ajo përtueshëm shkëputi shikimin nga sytë e mi. Pasi u mendua ca, e kafshoi sërish mollën... Më luti edhe mua të haja pak nga molla e saj. M'u kujtua koha kur kisha qenë dru molle, ndaj i thash "jo"; mbase nga që m'u duk se molla ishte pjesë e trupit tim. Pasi jo vetëm unë por edhe Ajo, do të kemi shëtitur nëpër do imazhe, që i analizova dhe do t'i analizoj gjithmonë, veçse rezultati ishte e do të jetë: imazhe prej një hapësire e një kohe tjetër. Më në fund u shkëputëm prej atyre imazheve, Vajza theu heshtjen:

"Në një jetë tjetër, ti ke qenë dashnori im", tha.

" E, si erdhe Ti këtu?!"

"Unë S'erdha... Erdhe ti!"

" ...."

Mbase, duhet të ketë qenë ashtu siç thoshte Ajo. Kushedi.

"Ku jam tani?! – e pyeta. Gjithçka këtu po më duket e huaj, përveç teje!"

"Ashtu si edhe mua. Këtu gjithçka është e huaj. Mbase kujtesa, malli e kujtesa do të kenë qenë të fortë. Malli shpoi muret e kohës. Dhe, të dy, me sa po kuptoj, u gjendëm në një dimension tjetër. As i imi as i yti. Dimension ku takohen dy të djeshme që ëndrra u ka mbetur në gjysmë."

" S'të kujtohet kur ata të fisit tim trupin ta bënë copë-copë me sëpata e sfurqe?!"

"Si nëpër mjegull..."

"Atje rrëzë pyllit, arrita para se ta merrnin trupin tënd. T'i putha sytë, pastaj ika. As sot s'e kam të qartë, pse në atë trup që gjithçka ishte e vdekur, sall sytë ishin ende gjallë?!

" S' të kujtohet?!"

"Po. Më kujtohet... Kjo është diçka që unë e kam shkruar në një libër. Mbase te romani *Në anën tjetër të pasqyrës.*"

"Hi, hi, hi, hi!", qeshi ajo, pastaj shtoi:

" Kjo është kujtesa jote, afshi i ardhur nga një botë tjetër!"

"Kushedi! Mbase?!"

"Shtatë ditë më vonë, pasi s'fjeta asnjë sekondë, piva helmin...

Aq shumë kisha mall të të shihja, qoftë edhe në ëndërr. E, gjumë s'kisha.

I vetmi shpëtim qe helmi..."

...

"Vdiqa dhe unë, shtatë ditë pas teje!"

* * *

Biçikleta u përplas në mur. (Kam përshtypjen se tre-katër herë, derisa e ngisja biçikletën, kam dëgjuar njerëz gjatë rrugës, të më kenë thënë: "Hej mos flej!") U rrëzova. Rashë në tokë. E kisha shtypur krahun e mëngjër. U futa brenda. Pasi piva një gotë ujë, u ula në kanape.

TV-ja tregonte shifra alarmante të vdekurish në botë nga korona virusi.

* * *

Nuk e di pse s' ndenja me vajzën e atij dimensionit tjetër?!

Kushedi?!

Rikard Ljarjes nuk i del qielli

Ese nga Roland Gjoza

Kur fillova punë në Kinostudio më 1982, shefja e kuadrit lexoi biografinë time aspak të mirë dhe në fund pyeti regjisorët dhe skenaristët nëse më pranonin apo jo. Gjer në ato çaste, pa ardhur ende shefja e kuadrit, (një nga ata të ish kontrollit punëtor) ndjeja dhunën e njeriut të shquar që po më shtypte: isha midis njerëzve të famshëm të kinemasë, që s'më besohej se një ditë do t'i kisha kolegë. Dhe tani pas asaj mynxyre, që një ish punëtore e tekstileve më kishte nxjerrë të fshehtat e familjes në shesh, pothuaj isha penduar që kisha lënë Pukën dhe pata ardhur në Tiranë, në shtëpinë time.

Rikard Ljarja pyeti: Ka më?

Çfarë? ia bëri shefja.

Ç'janë këto, t'i lëmë këto, tha Saimir Kumbaro. E urojmë që po fillon punë tek ne dhe ta mbyllim.

Nuk më dhe përgjigje, e mori fjalën sërish Rikardi duke e parë shefen në sy, ç'ka shkruar Rolandi? Kjo na intereson. Po ti s'na the asgjë.

Unë nuk e doja veten. Edhe kjo më mungonte. Rikardi s'dinte asgjë për mua.

Ishte njeriu më i heshtur. Sikur vuante prej një brenge. Ishte ajo koha kur e thërrisnin në hetuesi për Bashkim Shehun.

Dukej shumë i tronditur. E kishin ndaluar përkohësisht të bënte film. Një skenar të tij që ishte miratuar në Këshillin Artistik, ia dhanë një regjisori tjetër për ta xhiruar. I vinin rrotull. Ishin kohë shumë të turbullta, gati të pakuptueshme për artin. Mongoli i Madh kishte rrethuar Kinostudion, si dikur Çinghiz Khani Bresllavën në kufi më Gjermaninë për ta bërë dhe Evropën, si pjesën tjetër të botës, pluhur e hi. A do të binte Kinostudio?

Rikard Ljarjen e shikoja rrallë, ai pothuajse mungonte mëngjeseve kur në ora shtatë e gjysmë bëhej gjimnastika në oborrin e madh të Kinostudios si në Kinë. Ndjenja luftarake e ushtarit kaplonte çdo artist në ato mëngjese mobilizuese. Vet (vrasja) e Mehmet Shehut, kishte sjellë një frymë paniku dhe ankthi, shumë regjisorë dhe skenaristë merreshin në pyetje, ngaqë i biri i kryeministrit, Bashkim Shehu, skenarist në Kinostudio, ishte autori I një filmi të diskutuar të Rikard Ljarjes: *Sketerrë 43*.

Ai nuk shfaqej as në ambiente publike. Sepse nuk do ta linin rehat njerëzit. Batuta, qerasje, kamerierë, që i kërkonin autograf, pëshpërima nga të katër anët: Hej, Rikardi, hyri Riku, ej, mos e leni me pague... Dukej sikur në sallën e madhe të restorant Drinit, ku ai hynte nganjëherë i shoqëruar, netëve, shfaqeshin sekuenca nga filmat *Rruge të Bardha*, *Dueli i Heshtur*, *Komisari i Dritës*, *Plagë të Vjetra*. Ishte shumë simpatik. Një Marlon Brando ballkanik që ka punë me veten. Kjo përshtypje, që ai kishte shumë punë me veten, nuk më ndahej.

Nuk po bënte film. Ata që nuk paraqitnin skenarë, drejtori, Vangjush Zallëmi, njeri ideologjik, që kishte ardhur nga *Zëri i Popullit*, i thërriste në zyrë dhe u vinte afate, përndryshe i paralajmëronte me pushim nga puna. Ishte koha e 15 filmave në vit. Po ai i donte artistët e talentuar, madje i merrte në mbrojtje në momente tejet të rrezikshme, siç ndodhi më Çashkun kur bëri filmin *Dora e Ngrohtë*, një këndvështrim i ri ku cenoheshin disa tabu të paprekshme. Rikardi rezistoi. Ai nuk ngutej. Kishte një pakënaqësi fytyra e tij, një mërzi e letargji të çuditshme. Sikur prej tij pritej një zgjim.

Kujtoja personazhin e tij të famshëm, Dedën, te *Rrugë të bardha* më regji të Viktor Gjikës. Ja, që dëborës, mendoja atëherë, i shkoka shumë thjeshtësia, sinqeriteti. Rikardi aty luan me planin e dytë, siç shprehen në kinema, ai edhe dashurinë pothuaj nuk e shpreh, sepse di ta ruajë vertikalisht poshtë, siç fshihen thellësive, aty ku shpirti është më blu dhe virgjin, margaritarët. Kjo është më e vështira, ai, elementi i dytë, i pashfaqshmi, po më i dukshmi dhe më i efektshmi, kur bën majë në nyjëzat dramaturgjike, ose ajo që quhet teoria e ajsbergut, që shfaq dy të tetat e masës. Ky skrupulozitet i lakonizmit dhe i elipsit nuk erdhi si pasoje e ushtrimit mekanik prej mësimit të kolosëve si Eizenshtejni, po ishte një teknikë pothuaj e lindur, ndihmuar prej temperamentit, karakterit, kulturës së tij të shquar.

Ishte ajo kohë kur heroi pozitiv, eksplozion ideologjik, shkretnajë e lirisë së krijuesit, prej talenteve të mëdhenj shndërrohej në një paradoks humaniteti. Sekreti ishte thjeshtësia e pjekurisë artistike. Rikard Ljarja prapsej për t'u shfaqur, ndërkohë që të tjerë artistë, nguteshin zellshëm të dilnin në krye, ishin bërë prej kohësh pronarë të punishteve të fishekzjarreve. Ai, madje, nuk paralajmëronte, siç qe rasti i *Rrugëve të bardha*, po ikte, fshihej, si prej një mëkati. Kjo gjendje absurdi që e kaplon artistin e vërtetë, ndoshta vjen prej vetëmjaftueshmërisë, ai s'kërkon më për hir të asaj puplës mbi ujë që përcakton masën. Ai film, në vështrim të parë, është një agjit artistik, po gjetja e jashtëzakonshme e Vath Koreshit dhe interpretimi krejt njerëzor i Rikardit, i pëlqyer e i përcaktuar qartë në frakturën nëntekstuale të dramaturgjisë filmike prej Viktor Gjikës, e bëjnë filmin të shikohet edhe sot, jo prej nostalgjisë, po prej nevojës për mesazhe humane dhe vlerave të dukshme artistike. Ashtu njerëzor, si një i afërm, që ka munguar prej kohesh, trokiti Rikardi në familjen shqiptare dhe dihet se si u prit. Në kohën e tij ishte më i madhi, më i famshmi aktor i filmit, gjithmonë i munguar prej asaj masës, që përmendëm më lart që ia "hëngri shpirtin" Marjeta Ljarjes.

Po duku, o burrë, shfaqu, ç'e ke këtë dreq zakoni, që pas famës, që duhet shijuar natyrshëm, në vend që të bëhesh i vetëdijshëm për të, se e ke fituar me punë dhe talentin që ta ka falur i madhi Zot, ti merr arratinë... Po megjithatë ajo e kuptonte mirëfilli dhe e adhuronte si një tatu. Ishim në Shkup për një prezantim filmi, me sa mbaj mend, aty nga viti 1994. Marjeta nuk e hiqte nga goja Rikardin.

Në *Bit Pazar* më thoshte: Riku ka nevojë për nja dy këmisha për përditë, po edhe për këpucë... Ah, Riku, sa i pavëmendshëm është për këto leckat... M'i lë mua t'ia zgjedh... në fuajenë e hotelit: Roland, kur të kthehemi do t'i biem nga Tushemishti, jo nga Qafa e Thanës, kam përvjetorin me Rikardin dhe dua të ndez qirinj në Shën Naum. Atje e mbushi kishën e vogël me qirinj. Këtu është bërë ceremonia e martesës se babait dhe nënës, më dolën në ëndërr atje në Shkup.

Hodhem monedha në Drin nga ura e vogël dhe pamë atje poshtë peshqit dhe miliona monedha fati. Përjetë me ty, Riku, shpirti im, pëshpëriti, po nuk nxori lot, se Marjeta hyn te gratë e forta, të pamposhtura. Ç'ishte kjo ndjenjë dashurie për një njeri që s'bënte përpjekje për t'ia zgjuar? Ndoshta ishte ajo nuhatja mistike e rrëmimit në thellësirë ku fshihej shpirti. Marjeta e shfaqte bujshëm, me plot bukuri shpërthyese që i shkonte, ai e fshihte me një qetësi të paturbulluar, që pikërisht prej kësaj shpesh e harronin. Atje në Pogradecin e saj na dhuroi nga katër pesë kile koran të freskët për atë, Rikun e saj, të cilit mundohej si e si t'ia vinte në dukje famën, t'ia hiqte atë ndrojtje fisnike për të mos i munduar të tjerët me famën e tij. Dhe Marjeta dinte ta bënte këtë gjë, se ajo ishte gruaja e mrekullueshme që i përshtatej më së miri asaj thënies biblike të nënë Terezës: Nuk ka rëndësi çfarë jep, po sa dashuri ka në atë që jep. Jo, edhe dashuria e madhe e Marjetës, aftësia e saj voluntariste, talenti i shquar për biznes, nuk arritën të bënin asgjë, se Sfinksi i saj enigmatik, ishte edhe më i fortë dhe i pamposhtur.

Një ditë ai më afrohet dhe më thotë se kishte shkruar një skenar: *Kur hapen dyert e jetës*. Atë kohë drejtor kishim Viktor Gjikën. Këta e pranuan menjëherë, më tha, kjo më shqetëson.

Unë nuk e kuptova pothuaj, sepse ku ta gjeje të të fusnin në prodhim pa kaluar shumë hallka. Pasi e lexova skenarin i thashë me entuziazëm se aty fshihej një roman. Ti shkruan prozë, po nuk do të shfaqesh. Flasim njëherë tjetër, të lutem, mos i thuaj njeriu. Nuk i pëlqente t'i rrëmonin skutat. Gjithmonë e shikoja si në mëdyshje.

Filmi pati shumë sukses. Madje Ramiz Alia e mori si shembull. Isha caktuar të bëja një recension, që të nesërmen në mëngjes ta lexoja në mbledhjen e kolektivit para 200 a 300 vetëve. Mbeta i zhgënjyer. Rikardi ishte dorëzuar. Përveç një romantizmi dhe një filli poetik, në film bënte majë skematizmi, parulla e ditës: atdheu është kudo.

U mundova të zbuloja te Rikardi njeriun e dytë, atë të fshehurin, pjesën njerëzore të centaurit, po ai s'jepej. I pamposhtur në enigmën e vet. E gëzoi triumfin. Po ashtu i mbyllur në vetvete. Nuk i thashë asgjë, as që atë ditë nuk isha futur në sallë për të lexuar recensën, i pakënaqur me filmin. Ndërsa unë vërtitesha poshtë, atje lart në katin e dytë lexohej përshëndetja entuziaste e Ramiz Alisë, i cili theksonte se filma të tillë i duheshin partisë, popullit në ato kohë të vështira.

Pastaj më dha një pjesë të prozës së tij. Mbeta pa frymë. M'u duk një prozë e mrekullueshme. Një prozë dramatike, e thellë psikologjike, mbaj mend ca njerëz që shkojnë në mort dhe tjetër kujtojnë për të vdekurin, një emër të famshëm, tjetër qëndrim mbajnë ndërsa ai

përcillet me nderime për në banesën e fundit. Pushteti të denatyron. Dhe kjo është e pashmangshme në një vend të mbyllur. Ja, e gjeta Rikardin. Ai kishte frikë, ai ruhej. Nuk ishte heroi. Po kishte luajtur heroin. Filmi, Kinostudioja ishte buka, ekzistenca, përndryshe ai s'do të kishte ditur ç'të bënte me turpin.

Ai shkruante tjetër gjë. Proza e ngjeshur më dramë njerëzore ishte ajo pamje e menduar, ajo apati përplot mërzi në portretin e tij, strukja, vetmia, rrallimi i daljeve në publik. Ndërsa filmi ishte mbijetesa. Nuk ishte koha e "Babai shkon me shërbim", "Dollibash", "Shtëpia e varur", "Underground" të Kusturicës, po ishte një kohë shqiptare pa fat. Mjaftonte ajo rroga për të mbajtur shtëpinë, fëmijët, për të mos u dorëzuar.

Pastaj erdhi skenari tjetër: *Pesha e kohës*. Një copëz gazete, një përgjigje flakë për flakë e një direktive të partisë, pa dalë ende në dritë. Rëndësia e bujqësisë dhe e blegtorisë është jetike, të dyja zhvillohen krahas njëra-tjetrës si një prioritet. Dhe kështu fillon filmi, me një ndeshje futbolli në fshat ku luajnë bujqësia dhe blegtoria të cilat dalin në barazim. Dhe ato karaktere që vuajnë drama pa dramë, shpërbehen në vorbullën e ideologjizimit të tepruar, agjitacionit vulgar. Një Kadri Roshi, aktor i madh, që përpiqet të shpëtojë personazhin e vet. Po s'e shpëton dot.

Rikardi ndoshta priste një përshëndetje të dytë nga lart. Po s'ndodhi asgjë. Filmi nuk pati jehonë. Ai priste. Çudi, i kishte paraprirë një direktive që ishte diskutuar në forumet e partisë me dyer të mbyllura. Dhe ishte i bindur që kishte bërë diçka të mirë.

Roland, më thoshte, duke pirë së bashku nga një gotë birrë në një qoshk, artisti duhet t'i paraprijë fenomenit, duhen mbajtur veshët hapur. Këto ide që trajtoj në këtë skenar do të bëhen publike pas katër pesë muajsh. Kur të dalë filmi ato do të tingëllojnë shumë të freskëta. Po ndodh një ndryshim "revizionist", diçka po shpërbëhet në pronën shtetërore që dështoi. Do të vinë kohë më të mira. Çdo artist duhet parë në kontekst më kohën e tij, ç'ka bërë për ta shtyrë përpara, për të kapur e trajtuar fenomene të së ardhmes.

Ç'është e vërteta, mendimet e tij ishin përparimtare për ato vite të tatëpjetës së socializmit, po siç dihet, kafsha e goditur për vdekje në fund fare bëhet më e rrezikshme.

Po nuk dukej dhe aq entuziast. Ishte në natyrën e tij të dyshonte. Nuk e harroj një bisedë, për një arsye, që sot s'përfillet, ne folëm për natyrën e kompromisit. Kush artist e mohon këtë gjë, ai gënjen. Dukej sikur gjithçka bëhej me ndërgjegje, po kjo ishte një pandehmë dhe pandehma merrej për të vërtetë. Për shumë arsye, që përgjithësisht kishin lidhje më deluzionin absurd të ekzistencës. Sepse ishte mallkim të bëje art kinse duke i besuar gënjeshtrës që trilloje vetë. Kur dihet mirëfilli që arti kërkon vërtetësi dhe sinqeritet.

Mitomania, sëmundje e kohës. Pastaj vetësugjestioni prej trysnisë që mbi ty rëndon dyshimi dhe je i kërcënuar. Atmosfera e mbushur me terror të brendshëm, me pëshpërima se intelektualët po shkasin nga vija. Alarmi i kudopërhapur se partia më tepër se kurrë ka nevojë për besnikëri. Përndryshe...

Kur i thua këto sot, ndoshta nuk kuptohen më. E kanë humbur tragjizmin që fshihnin. Ishte koha kur fare rastësisht, poshtë pallatit tënd të ndalonte makina e druve. Për mua kanë ardhur? – do të pyesje veten me llahtari duke i vënë veshin hapave që nxitojnë. Lart tek apartamenti i profesorit ngjiten ata të Dëbim Internimeve, hedhin nga dritaret e katit të pestë tesha e mbulesa, nxjerrin poshtë profesorin e hutuar me të shoqen e alarmuar dhe me fëmijët që qajnë dhe i shtyjnë të ngjiten lart në karroceri. Dhe makina që në mëngjes ka shpërndare dru zjarri, tani në muzg niset drejt një Gulaku shqiptar, një humbëtire me tela me gjemba dhe roje, ku pula ha gurë. Gjëma të papritura si kjo, për të trembur e llahtarisur të pabindurit, apo të pavendosurit, veçmas ata të aradhes së inteligjencës, po lihen kinse të harrohen.

Po proza që shkruante Rikardi, ajo prozë krejt ndryshe?

Ra Muri, nuk punohej më. Ëndrra, papunësi dhe uri. Po më shumë ëndrra.

Erdhën dhe m'u prezantuan, më tregonte Rikardi, ishin producentë, vinin nga Gjermania. Ke dëshirë të vish me ne, më thanë, do të jetë një udhëtim shprese për ty, pse jo, dhe fame. Nuk më sqaruan asgjë. Një hotel i mirë, një apartament komod. Unë fill i vetëm. Më treguan afishet e para. Emri im më germa të mëdha. Titulli provizor i një filmi. Diçka fantastike. Siç mora vesh më vonë më kishin zgjedhur si një regjisor të lindjes që do të dilte me një film për diktaturën. Skenarin e dorëzova shpejt. E pëlqyen. Ishin gati ta financonin. Net të tëra që mendoja se pse pikërisht më kishin zgjedhur mua, ç'garanci jepte talenti im, mos ishte e gjitha një mashtrim? As sot nuk e di ç'ishte. Prita një kohë të gjatë, po nuk mora asnjë përgjigje. Më kishin braktisur. Dhe sot mendoj: a ishte e vërtetë?

Është bërë më i heshtur. Rri mbyllur. Pas 97-tës niset në Greqi te gruaja, Marjeta dhe fëmijët. Ç'mund të bënte atje? Të punonte? Po ç'punë konkretisht? Qëndroi disa kohë si në absurd pa rënë në ujdi as me perënditë as me Eskilin, as me dreqin e të birin dhe u kthye në Shqipëri.

Tranzicioni ishte stres për të, depresion. Ishim të dy në Budapest në një festival filmi. atë natë që mbërritëm vajzat e shkollës së artit kërcyen me ne. Rikardi merrej vesh gjermanisht. Ishte atmosfera e tij ndërsa kërcenin valset e Shtrausit. Aty pashë një Rikard të ri përplot projekte. Të nesërmen ai ishte përsëri i zymtë dhe nuk donte të dilte të shikonte Budapestin. Këmbëngulja e Mihallaq Luarasit dhe e Edit, një çift mjaft simpatik, më në fund e nxorën nga dhoma. I treguan hotelin e Zogut, ai paskësh pasur në Budapest një hotel, pastaj i dhanë xhin në një hotel tip *La Skala* me lozha në formë rrethi përbrenda plot me banja termale, ku notonin në ujin me ngjyrë kobalti çifte të vjetër. Nuk i zgjonte kureshtje të veçantë asgjë. Na çuan tek urat që lidhnin Budën me Pestin. Aty gati çdo javë i jepte fund jetës një njeri. Shumica ishin të rinj. Nuk dihej shkaku i këtij depresioni. Ndoshta prej mjegullave dhe shiut të imtë që s'të ndahej.

Rikardi ishte natyrë analitike, e thellë, herë–herë nxirrte përfundime kaq të çuditshme.

Shikoji, më thoshte një mëngjes kur u ulëm në tryezën tonë për të ngrënë mëngjes, të gjithë rrinë bashkë: serbë, kroatë, sllovenë, sllovakë, çekë, malazezë, maqedonas, bullgarë, boshnjakë, madje kanë bashkuar dhe tryezat. Vetëm ne rrimë të veçuar dhe ata s'na ftojnë, sikur të mos ekzistojmë. Kjo ndodhi menjëherë, që ditën e parë, e vure re, sepse ata kanë një gjuhë dhe merren vesh me njëri-tjetrin. Prandaj jemi autoktonë, kemi gjuhën tonë. Ndryshe kush do të na linte të banonim në pjesën më të bukur të botës që i thonë Mesdhe? Po fati s'na ka ndihmuar, prandaj jemi kaq konfuzë dhe të vonuar.

Tani brezat e rinj nuk e njohin pothuaj. Edhe po të shfaqet, bie fjala, te Blloku, nuk do ta njohin. Vetëm ndonjë nostalgjik në moshë do të thotë: Ky është Rikard Ljarja, pa krijuar kurrfarë zhurme përqark. Ai e di këtë dhe ruhet. Dikur prej turpit, sot prej fyerjes. Po kjo është shumë e rëndë për një artist që dikur konsiderohej si një pjesëtar i familjes shqiptare. Për famën e tij humori shkodran nxori batutën e famshme: *Sa vllazën baheni? Katër me gjithë Rikardin.*

Sot Rikardi mban një qen: Sheperd, më duket, sepse ai ka nevojë për shumë dashuri. Artistët e vjetër janë harruar. Dhe ai është harruar pothuaj. Politika çoroditëse shqiptare që na bëri ta shikojmë sërish jetën bardh e zi, rroposi bashkë me komunizmin, edhe artin, e anatemoi pa dallim, stigma morbide ra mbi te. Krijimtaria e para 90-tës u dënua me mllef verban, u shty mënjanë në harresë. Duhen kohë, shumë kohë që të krijohet sërish institucioni dinjitoz i artit, që tani ka marrë rrokullimën dhe një artist, një artist i madh si Rikard Ljarja, të rinjihet si në baladat e moçme. Rinjohja, ç'fjalë dramatike, ndoshta e shqiptuar së pari në teatrot antike greke ku luhej Eskili apo në Globusin e Shekspirit dhe e mbetur sërish në harresat e urtive, të urtive të mundimshme prej përvojave, që sot, për dreq, s'ua vë veshin njeri. Sepse vipat e përkohshëm javorë të spektakleve fitimprurës, që prodhojnë gallatë, prej gjithë atij Shekspiri, kanë nxënë e pranuar vetëm lolon e pallatit.

Siç shikohet, unë nuk u mora dhe aq më sukseset e Rikardit, se ato nuk do t'i bënin fort përshtypje atij, po vetëm sa ngacmova atë plagën e të gjithë artistëve që ishin të detyruar të mbijetonin duke bërë kompromisin e pashmangshëm. Kjo nuk është dhe aq e këndshme, ta thuash, madje tingëllon e hidhur, me një dozë ironie, po pikërisht pa këtë lexim të kësaj enigme, pa hedhur dritë mbi këtë skutë që dhëmb trishtueshëm, nuk mund të shpjegojmë vuajtjen prej dyzimit morbid të artistit në diktaturë.

Tani së fundi dy gjëra më kanë mbetur në mendje prej tij: e ka lënë Tiranën e zhurmshme të kafeneve, ku çdo ditë lind një gjeni ndërkombëtar dhe e shtyn jetën në Shkodër, në atë copë shtëpi që i ka rënë për pjesë. Dhe ndjehet i qetë, i bëhet se po jeton njëfarësoj. Punon në kopsht, pret ndonjë mik, shkruan në vetmi, luan ndonjë rol më të rrallë në *Teatrin Migjeni*.

Kur kthehet në Tiranë, mbështetet te dritarja e shtëpisë (ka ndërruar shumë shtëpi gjer tani) dhe shikon avionët, ndjek linjën ajrore. Jo se ëndërron ende për ndonjë të panjohur si ai i Gjermanisë, që do të vijë prej Evropës, e cila afrohet duke u larguar e do t'i kumtojë se është i përzgjedhur, po, siç thonë, ai numëron, jo për arsye utilitare, po më fort prej dhimbjes se imazhit, (filmit) sa avionë shkojnë e vijnë në ditë, bën llogaritë dhe i del se me një pjesë të taksave që merr shteti prej tyre mund të bëhet dhe ndonjë film i mirë. Po shteti po tregohet dorështrënguar më artin. I ka kthyer shpinën.

Dhe Rikard Ljarja i ka kthyer shpinën shtetit i përpirë në harresën më tragjike.

Nju Jork 2010

(Nga libri «Zogjtë e Hiçkokut», Uegen, 2014)

STUDENTËT E LETËRSISË NË DITËN BOTËRORE TË LIBRIT

nga Lili Sula
Përgjegjëse e Departamentit të Letërsisë, UT

Departamenti i Letërsisë i Universitetit të Tiranës kremton në të 12 vit Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit përmes veprimtarish që përcjellin vlerën e librit në transmetimin e dijes e të kënaqësisë së leximit.

Ky vit erdhi ndryshe, na munguan auditorët, na mungoi një pjesë e veprimtarive që hijeshonin ambientet e brendshme e të jashtme të Fakultetit për çdo 23 Prill e që e shndërronin atë në ditë feste për studentë e pedagogë. Por pikërisht këtë vit akademik, me ngjarje e situata të pazakonta, që do të mjaftonin për të mbushur me dëshpërim edhe një jetë të gjatë njerëzore, nuk mund ta linim pa u takuar, aq më tepër kur ishin të parët studentët që u interesuan për veprimtaritë e Ditës së Librit dhe ishin plot ide.

Të bindur se sot është shumë më e nevojshme për të zhvilluar veprimtari me studentët e njëherësh me bindjen se u takon studentëve të Letërsisë të jenë në qendër të saj, mbështetëm idetë e tyre.

Prej vitesh *Festivali i krijimit letrar* është pjesë e pandarë e veprimtarive të Departamentit të Letërsisë. I ideuar dhe i organizuar nga vetë studentët, nën kujdesin e pedagogeve dhe poeteve, Viola Isufaj dhe Belfjore Qose, pjesëmarrësit transmetuan dashurinë për librin e letërsinë në përmasën më qenësore të saj, të shpirtit krijues. Festivali përshfaqi shpirtin krijues të studentëve në komunikim artistik të përbashkët, si dëshmi e përvojë e kreativitetit dhe talentit të tyre e si pjesë e traditës së studentëve të Degës së Gjuhës e të Letërsisë Shqipe, të Universitetit të Tiranës, prej të cilëve kanë spikatur personalitete të dijes albanologjike, studiues të mirënjohur të letërsisë, mësues të përkushtuar, shkrimtarë e poetë të shquar.

Këtë vit, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe të Leximit, që mbështet e inkurajon autorë të rinj, publikuam dy libra *online: Festivali i Krijimit Letrar, 2017-2019* dhe *Tinguj nga sirtarët,* përmbledhje me studime nga studentët mbi Zef Zorbën.



Synojmë që këto botime të ndiqen nga të tjerë për të vijuar traditën, që i takon studentëve të letrave të bukura, në publikimin e krijimeve të tyre.

Botimi i krijimeve të studentëve, *Festivali i Krijimit Letrar: 2017-2019,* përcjell një komunikim plot sensibilitet me misterin e krijimit, me gjurmë nga jeta studentore e formimi profesional, të mbushur me lexime të autorëve të famshëm të letërsisë sonë e asaj botërore, sa dhe me lexime vetjake. Ai vjen në këto kohë të pazakonta për të gjithë e frymon fuqinë e fjalës artistike kundër izolimit, mpak distancimin social ndërmjet nesh, duke na përcjellë dashurinë për letërsinë e leximin përmes udhëtimit imagjinar nga jeta e përditshme e studentëve, te raportet e tyre intime, nga shqetësimet sociale të vërejtura me sy kritik, te pyetjet e mëdyshjet individuale në rrafsh meditativ e filozofik.

Në 100-vjetorin e lindjes së poetit Zef Zorba, një ndër më të mirëve poet të vargut modern të poezisë bashkëkohore, që i ka munguar gjatë lexuesit e letërsisë sonë, në shenjë mirënjohjeje e vlerësimi të pamatë për kontributin e tij në letrat shqipe, u botua libri *Tinguj nga sirtarët*. Profesoresha Viola Isufaj ka përgatitur për botim këtë përmbledhje studimore mbi krijimtarinë e poetit, e para e këtij lloji, me punime të studentëve të degës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe, që vjen si dëshmi e parë e dëshirës dhe vullnetit të tyre për punë kërkimore. Para pak vitesh, ajo bëri të mundur përfshirjen e veprës letrare të Zorbës në programin mësimor të lëndës së *Poezisë Shqipe Bashkëkohore*, për të vijuar me studimin e veprës së tij edhe me udhëheqjen e tezave të diplomave, duke iu qasur këtij poeti nga pikëvështrime të ndryshme e të thelluara. *"Në gjysmën e dytë të një shekulli plot pështjellime politike, të cilat nuk lanë pa prekur e dëmtuar trungun e letërsisë shqipe, bëjnë jetë në errësi, për t'u shfaqur më pas, në dritë të plotë, këta poetë (M. Camaj, Z. Zorba - shën. im) me modelet më ekzemplare të shkrimit të poezisë moderne shqipe",* shprehet ajo në pasthënien e librit. Studentët rrokin poetikën e veprës së poetit në marrëdhënie me hermetizmin ("Përkime e ndikime në poezinë e Zef Zorbës", Marinela Hysenllari), me muzikën ("Marrëdhëniet muzikore në përmbledhjen poetike *Buzë të ngrira në gaz",* Adriana B. Sadiku) dhe religjionin ("Kalvari i marrjes së kryqit: poezia Sa mirë, atëherë...", Ledio Hala), për t'iu qasur shqipërimit të poetëve të mëdhenj italianë që na ka lënë poeti Zorba (*A Silvia* e G. Leopardit, në përkthimin e Z. Zorbës, Kristiana Mihani).

Një tjetër shprehje afiniteti për librin, letërsinë e leximin përcjell *Vox Lettera 2020,* që bashkoi studentët e *Klubit të Dramës* e pedagogët e Departamentit të Letërsisë, nën kujdesin e profesoreshë Erenestina Halilit. Në shenjë nderimi e respekti të jetës dhe krijimtarisë së autorëve tanë që kanë përvjetorë këtë vit: P. Bogdani, N. Frashëri, A. Z. Çajupi, Gjergj Fishta, Faik Konica, L. Skëndo, V. Prenushi, L. Shantoja, E. Koliqi, Z. Zorba, A. Pipa, M. Camaj, A. Pashku, F. Rreshpja , Xh, Spahiu, S. Hamiti, studentë e pedagogë përmes realizimit mbresëlënës të video-mesazhit, artikuluan fuqinë

e komunikimit artistik përtej çdo distancimi social.

Në ditën simbol të Librit dhe të së Drejtës së Autorit, Departamenti i Letërsisë, i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës bëri bashkë studentë e pedagogë në një realitet virtual, duke i zhvilluar veprimtaritë *online* në faqen e Fakultetit (të aksesueshme edhe në You Tube). Ai iu bashkua veprimtarive të UNESCO-s për Ditën e Librit 2020, e cila në këto kohë të turbullta për të gjithë thekson rolin e leximeve të përbashkëta për të ndihmuar njëri-tjetrin të dalim nga vetmia e për të krijuar ndjenjën e bashkësisë nën moton se "Librat kanë aftësinë unike për të na mësuar e argëtuar. Përmes autorëve, kulturave e botëve të ndryshme, ato janë mjet shtegtimi përtej përvojave tona personale e njëherësh mjet depërtimi në skutat më të thella të botës sonë të brendshme."

PSIKONARRATIVA E ZHGJËNDRRËS
(*Aksidenti* i Kadaresë)

nga Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)

Në këndvështrim psikonarrativ e psikanalitik, *Aksidenti* i Kadaresë është ndërtuar me një rrëfim të narratorit të gjithëdijshëm në trajtë zhgjëndrre/ përmendje pas ëndërrimit dhe me një gjendje të ndërmjetme ëndërrim/ paraepasëndërrim, që zbulojnë vetëdijen e protagonistëve. Zbërthimi i marrëdhënies mes stazhieres së Institutit Arkeologjik të Vjenës, vajzës 23-vjeçare, Rovena St., dhe analistit që bashkëpunonte me Këshillin e Evropës për çështjet e Ballkanit Perëndimor, Besfort Y., shërben si kryetregimi e kryehetimi që na drejton në kryeenigmën e historisë së rrëfyer – *aksidentin* ose/ dhe *vrasjen*, për të cilën herë rrëfen narratori e herë vetërrëfejnë personazhet. Paraqitja e karaktereve kadareane si figura të ngrira danteske, me ndriçim të zbehtë; lidhja frojdiste *thanatos–eros*; ndërkëmbimet "mauzole–motel" dhe "padron–vajzë luksi"; gjendjet *ante-* dhe *post-mortem* luajnë një rol kyç në narracion, ku rëndësi parësore, më shumë se shpalosja e domethënieve, ka zbërthimi i këtyre përbërësve përmes marrëdhënies *psikonarrativë–zhgjëndërr*. Në rikujtim të marrëdhënieve/lidhjeve dashurore spikat ndërveprimi i ndërsjellë thanatos–eros, përmes të cilit narratori-investigues supozon se shpjegon dukuritë jetësore të personazheve, duke i ndarë përfundimisht, njërin në ***thanatos*** (Rovenën – personazhin *femër*), tjetrin në ***eros*** (Besfortin – personazhin *mashkull*). Në funksion të shtytjeve të egos, ashtu sikurse shpjegon Frojdi, edhe karakteret kadareane – si individualitete – qëndrojnë në vetvete (*egoizëm*); dhe tejkalojnë vetveten vetëm kur bashkohen me karakterin/ individin tjetër. Egoja i drejton në shtysat seksuale, duke i vënë në konflikt të përjetshëm.

Karakteret janë në të njëjtin rrafsh, me ndriçim thuajse të zbehtë, dhe e gjejnë veten në një ngrehinë të ndërmjetme, njëfarë *mauzoleu-motel*... Kthimi i së dashurës në "call girl", ishte një mënyrë për t'i hequr asaj "kurorën" e dashurisë. Në këtë pikë, personazhet zbehen gradualisht, për t'u ngurtësuar e shpërfaqur si figura "të ngrira" danteske, shndërruar në *basoreliev gipsi e të mermertë*, duke mos guxuar shkeljen e paktit të përjetshëm midis klientëve dhe vajzave të qejfit: *mosputhjen*... Konfiguracione të tilla përftohen nga ndryshimi në rrafshin diskursiv-semantik dhe në marrëdhënien e tyre: *e dashur* vs. *call girl* si eufemizëm/faza embrionale, dhe *kukull* vs. *ein mannequin*/ftohja e dashurisë. Vajza në taksi "nuk" ishte më Rovena St., por shëmbëlltyra e saj: Pra, udhëtari, njeriu, po përpiqej të puthej me një trajtë. Ose trajta me njeriun (*Vepra 17*, f. 207). Rindërtimi i skemës përfundimtare prej hulumtuesit, lidhet me katër elemente kyçe: një çift dashnorësh; një kukull; një puthje e pamundur, dhe kryesorja një vrasje. Rrjedha rrëfimore, e cila fillon së prapthi, me vdekjen e personazheve e më pas me rindërtimin e jetëve të tyre të njëmendta, ka *efektin e suspansës/ pezullimit*, që vjen si një kombinim mes pritjes e pasigurisë. Jetët njerëzore dukeshin kaq të përafërta sa shëmbëllenin mijëra vjet, siç shëmbëllen pasqyra imazhin e saj, aq sa pluhuri i harresës nuk ka mundur t'i tjetërsojë. Universalizmi i jetëve njerëzore dhe rishfaqja e arketipave njerëzorë, nuk përbën një temë të re në veprën kadareane, po në romanin Aksidenti risi është se shfaqen të rimishëruara nën simbolikën mitike të pasqyrëzës së taksisë. Kështu, jeta e brendshme e një personazhi/ individi bëhet "tabelë e tingëllimit për të vërtetat e përgjithshme të natyrës njerëzore... dhe zbulohet vetëm tërthorazi përmes gjuhës së folur dhe rrëfimit" (Dorrit Cohn, *Transparent Minds*, f. 23, 21).

Marrëdhënia e dyshimtë e protagonistëve vërtitet rreth një **historie** në dukje "**fantazmash**", një pezmi që vjen <u>jo prej vdekjes natyrore, por prej vdekjes së dashurisë</u>. Vdekja barazohet me fundin e dashurisë dhe jo si shkëputje e shpirtit prej trupit. Zbritja e Orfeut në ferr, për të nxjerrë Euridikën, ndoshta duhej zbërthyer ndryshe – e vdekura nuk ishte Euridika, po dashuria. Në fund të romanit, Rovena St. quhet prej Besfort Y., Euridikë, por si mishërim i vdekjes së dashurisë, ndërsa miti orfik trajtohet si udhëtim i njeriut brenda nënvetëdijes së vet, për të rifituar dashurinë e humbur – ripërtëritje ndjesish të kësaj-e-asajbotëshme, pjellë "zonash të huaja e të paskaja"...

Si e pikturuar përnjëmend në një vazo japoneze, të veshur me krizantema mallëngjyese, dashuria e tyre krahasohet me shtratin e ndarë më dysh të një hoteli, përngjarë me dy varre dashnorësh të dikurshëm. Lidhja frojdiste thanas–eros, mbizotëruese edhe në vepra të tjera të Kadaresë (*Muzgu..., Prilli i thyer, E penguara.., Hija, Vajza e Agamemnonit, Aktori* etj.), në këtë roman njëjtësohet me dashurinë e shndërruar në shkrumb...



Aluzioni i varrezave të Kiotos inicion *ftohjen e marrëdhënies në çift*, ndërsa pllaka e mermertë dëshmon, si një epitaf, gjurmët e historisë së tyre të brishtë. Gjendja post-mortem na zhvendos në një zonë tjetër të mendim-veprimit, e cila nuk ngjason e kësaj bote edhe pse fillimisht përfytyrohet pa fjalë, vishet me fjalë e më pas rrëfehet për të tjerët. Narratori-investigues rindërton herë pas here kronikën tokësore të asaj që kishte ndodhur në çastin final, që, siç shpjegon Platoni prej antikiteti, s'ishte veçse një pasqyrim i zbehtë i modelit të përjetshëm. Në këtë dashuri, të qenit zgjuar kishte më përparësi se të qenit me sy mbyllur... Rovena kishte rënë në *dashuri* (fjalë e shënuar me germa kursive); "padroni" i kishte dhunuar asaj natyrën – psikikën; i kishte "sëmurur" shpirtin. Afrimi i trupave mbetej gjëja më e thjeshtë në botë, aq sa "zhveshja merrte aspektin e një rituali" (J.-P. Champseix), por i vështirë mbetej afrimi i shpirtrave, aq sa e kthen raportin Besfort–Rovena në një "antropologji të thurur me tregime të panumërta, të para si rrëfim i të vdekurve". Me afrimin e gjumit, ndjesia greminore e humbjes pa kthim, zbutej aty për aty, dhe Rovena kalonte lehtësisht në "**zonën tjetër**", që ngjasonte si bashkim i thërrmijave të ëndrrave. Kjo zonë, aq shumë e përfolur në letërkëmbimet e në bisedat telefonike, i ngjasonte një tjetër planeti, një kapërcimi, një zhvendosjeje, që funksiononte me të tjera ligje dhe kishte fuqi hipnotizuese mbi protagonistët, sepse tashmë gjithë mjegullnajën dhe moskuptimet mes tyre i sillte ***shpirti***, e jo ***trupi***.

Në psikonarracion, narratori heterodiegjetik mbetet në rrafshin e parë. Dysia e personazheve kadareane shfaqet në sytë e lexuesit përmes vëzhgimeve të tij të gjithëdijshme, ligjërimit për gjendjet shpirtërore, ndijimet, fotografitë, letërkëmbimet dhe shënimet në trajtë ditari. Lexuesi mënjanohet paqëllishëm nga vetëdija e tyre. Ndërmjetësimi mes "dëshmive faktike", për të hedhur dritë mbi jetën dhe marrëdhënien spekulative *padron–vajzë qejfi*, dhe zhaurimës së ngjarjeve që ndodhin në sipërfaqe, jepet në kundërshti të plotë me heshtjen e thellësisë, duke anuar jo nga ***ante-mortem***, por nga ***post-mortem***, për të mos gjetur thuajse asgjë të rrokshme apo "të saktë" në atë histori. Çdo rindërtim i ndoshisë së aksidentimit kthehet në një kështjellë pluhuri, të cilën e zhduk, me një të fryrë, rindërtimi i radhës. Gjurmët e së panatyrshmes spikatin në grimat e historisë, çka dëshmon se dëmtimi kishte ndodhur që në thelb. Takimi para vdekjes, që cilësohet prej tyre si post-mortem është çelësi për të zbuluar, ose edhe për ta kyçur, tisin e misterit që ngërthen rrëfimin deri në sentencën e fundit. Cinizmi në pusullën e fundit: "Lidhur me kushtet, okej si herën tjetër?", që do t'i bashkonte në hotelin "Miramax", e përmbys skajshmërisht këtë histori, e cila kishte një "mbrapshtësi në thelb". Karakteret kadareane nuk janë gjë tjetër veçse dy njerëz vulgarë që bëjnë teatër, që hiqen si dashnorë luksi, sipas gjedheve të njohura e vërtiten incognito, me petka endacakësh, teksa "kërkonin ta maskonin dashurinë e tyre pas dukjes lavire– pusht" (*Vepra 17*, f. 46). Shkallëzimi i dozës së bisedave, hierarkia e shprehjeve, frazat e dialogëve apo të pusullave, tingëllonin gjithnjë çuditshëm, ngjanin të përçudnuara, pa logjikë të brendshme, pa tharm e me lëndë gjuhësore kishte pësuar një lloj mpirjeje, rrjedhojë e një tronditjeje të beftë... Paraqitja e motërzimeve të ndryshme për të njëjtën ndodhi bën që lexuesi të konfuzohet dhe tensionet narrative e pasiguria të vijojnë deri në përmbylle të rrëfimit. Rrjedhat kohore akronologjike shfaqen përmes përmbysjes së riteve ceremoniale: *Kjo **rrjedhë së prapthi** (të dyzetat, të shtatat dhe pika zero, që njehsoheshin përpara vdekjes dhe jo pas saj, sipas zakonit gjithënjerëzor), ka qenë shtysë për të dhënë **vizionin e përmbysur*** për kohën e dy të dashuruarve, nëse do të quheshin të tillë (*Vepra 17*, f. 184). Afrimi i pikës zero, çuditërisht nuk ngjall panik te personazhet, por te hetuesi, që sipas tij, nuk kuptohej se çfarë ishte: mbarim, fillim, të dyja bashkë apo asnjëra prej të dyjave. Është pikërisht pika zero, ajo që lidhet me shprehjet "call girl" dhe post mortem. *E përdornin të dy, por në të vërtetë, post-mortem ishte ajo dhe jo ai. <u>Me ato fjalë kishte nisur vdekja e saj</u>.* (*Vepra 17*, f. 196). Në fazën kur Besforti përdorte "call girl" kishte nisur vdekja e dashurisë. Takimet post -mortem (pas vdekjes), nuk ishin veçse takime në ante-mortem (para vdekjes/në jetë) – perceptim mendor i sjellë përmes rrëfimit të dyzuar: *jetë–mosjetë, e vërtetë–mister, dashuri– jodashuri*. Aksidentimi ose/dhe vrasja e Rovenës St. shfaqet/n si psikikë për ta ndjellë femrën pashmangshmërisht drejt mashkullit. Kadareja e paraqet psikikën e protagonistëve "ilustruar" përmes psikonarracionit, duke "e vendosur psikoanalizën në fjalët e narratorit" (Dorrit Cohn, *Transparent Minds*, f. 11).

Zhvillimi i semantikave leksikore dhe dekodifikimi i mekanizmave gjuhësorë na çojnë sërish në çastin fillestar narrativ, duke bërë që koha jo vetëm "të ngrijë", por edhe të kthehet pas, si tentativë për të zbërthyer enigmën e historisë së rrëfyer. Rrëfimi post-mortem mbetet një autopsi/ekzaminim i ngjarjes e jo i trupit. Parrjedhshmëria e dëshmive, turbullira, rrokullima, gjendjet halucinante gjatë rindërtimit të historisë kulmore – *aksidentit*, ligjet e përbotshme, që zunë fill me gjenezën njerëzore, por që mbeten të pashpjegueshme deri në përditshmërinë tonë, krijojnë mospërputhje mes trupave të gjallë (*trup/shpirt*), plastikës (*trup/ dëshirë*), gjendjeve paraepasjetësore (*ante-* e *post-mortem*), kohës së shkuar (mungon dëshpërimisht *e tashmja*) dhe kohës që pritej të vinte. Në themelnajë, me sa duket, mbetet thjesht një kukull/e pashpirt (*ein mannequin*), shëmbëlltyrë e së dashurës – dëshira për ta zëvendësuar atë me një sajesë, me një sendërgjim, me një trup, me një trajtë...

2019

NJERIU VITRUVIAN

ese nga Moikom Zeqo

NJERIU VITRUVIAN

... *O Anthropos!* - Ç'është *Njeriu Vitruvian* (?) – Zeusi është *algoritmi* mbi tërë zotat paganë – i njëjti Kryezot është *"Hadi dhe Dionisi"*, siç thotë Herakliu i Errët i Efesit, - një mëngjes të vitit 1851, - tregon *Baudelaire*-i.- Parisi u zgjua me mankthin e Revolucionit, - dhe ja ndodhi, që në një gosti në përkujtimin të Revolucionit të shkurtit 1848, - një intelektual i ri propozoi një dolli për Hyun Pan, - "Por ç'lidhje ka Hyu Pan me Revolucionin e pyeti Baudelaire-i – duke shtuar "nuk është e vërtetë se Hyu Pan nuk ka vdekur?" – intelektuali i ri ju përgjigj "Hyu Pan e bën Revolucionin, ai është Revolucioni, - Baudelaire i këmbënguli: "mendoja se Hyu Pan ka vdekur, - ishte dëgjuar një zë i fortë mbi Mesdhe dhe se ky zë misterioz, - që kumbonte prej Kolonave të Herkulit, deri në brigjet e Azisë, - duke i thënë Botës së Vjetër se *"Pani ka vdekur"* – por intelektuali i ri tha: "është një zë që vrapon, fluturon, - jo, Hyu Pan mbijeton ende, vazhdon t'i mbajë nga qielli sytë me dhembshuri të çuditshme" – ndoshta shëmbëlltyra metaforike e Hyut Pan është edhe *Njeriu Vitruvian* (?) - *Markus Vitruvias*, lindur në vitin 80 para Krishtit, qe një inxhinier romak i specializuar për ndërtimin e makinerive luftarake, - ai qe edhe arkitekt, - vepra e tij më e rëndësishme është libri i shkruari *"De architectura"* – në një manastir në Zvicër humanisti *Poggio Bracciolini* e gjeti një kopje në latinisht të veprës së Vitruvit dhe e bëri të njohur në Firence – Leonardo Da Vinçi e kishte rilexuar me admirim Vitruvin dhe kuptoi marrëdhënien midis mikrokozmosit të njeriut me makrokozmosin e botës, - *"të gjithë artet dhe të gjitha rregullat e botës rrjedhin nga trupi njerëzor, - i krijuar me përsosmëri dhe dimensione harmonike"* – trupi i botës është analogji, metaforë e tërë botës, - projektimi i tempujve varet nga simetria (shkruan Vitruvi) – gjatësia e këmbës është një e gjashta e gjatësisë së trupit, - parakrahu është sa një e katra dhe gjerësia e gjoksit është sa një e katra – këto përmasa merreshin parasysh nga skulptorët e antikitetit – teksa trupi i njeriut krijon një kontur rrethor, por n ë të njëjtën kohë, në të njëjtën mënyrë mund të nxirret edhe një katror – rrethi dhe katrori harmonizohet, - Leonardo Da Vinçi e vizatoi *Njeriun Vitruvian,* - një trup mashkulli, - ku kërthiza e njeriut është në mënyrë të përpiktë në qendër të rrethit dhe organet gjenitale janë në qendër të katrorit – Leonardo Da Vinçi qe 38 vjeç kur e bëri *Njeriun Vitruvian*, - studiuesit mendojnë se fytyra është një vetëportret i artistit – *"çdo piktor pikturon veten"* – brenda katrorit dhe rrethit shohim esencën e Leonardo Da Vinçit dhe esencën e vetes tonë, në qendër të ndërlidhjes së tokësores me kozmiken – *Luca Pacioli* si kryematikan e lavdëron Leonardon, - e quan *"geniu arkitekt, imagjinar, shpikës"* – në kështjellën Sforca – Leonardo në 9 shkurt 1488 lexoi librin e tij për Pikturën, të quajtur *Paragone,* - në këtë traktat ai flet për një *"Kreativitet të Kombinuar"* – si dhe për lojën midis *Vrojtimit* dhe *Teorisë* – ndërkohë në studimet e tij matematikore, - Leonardo bëri një dallim midis sasive numerike, të cilat përfshijnë njësi të pandryshueshme dhe njësi të papjestueshme, dhe sasive të vazhdueshme të llojit që gjendet në gjeometri, ku përfshihen përmasat dhe shkallët, të cilat janë pjesëtueshme pafundësisht, - "midis Dritës dhe Errësirës gjenden variacione të pafundme, sepse sasia e tyre është e vazhdueshme" – *"piktura bazohet mbi perspektivën, - perspektiva nuk është gjë tjetër veçse një njohje e plotë mbi funksionimin e syrit"* – për pikturën, shënon Leonardo, - me madhësi sa një mur, kërkon një përzierje të perspektivës natyrore dhe *"perspektivën artificiale"*, - ai vizatoi një diagramë dhe e shpjegoi kështu: "në perspektivën artificiale, kur objektet e përmasave të pabarabarta vendosen në distanca të ndryshme, - më i vogli është më pranë syrit sesa më i madhi" – duhet të zvogëlosh mprehtësinë e kontureve të atyre objekteve në raport me distancën e atyre në rritje nga syri i spektatorit – pjesët, që janë afër në plan të parë duhen përfunduar në një mënyrë të qartë dhe të guximshme, por ato në distancë duhet të mbeten të papërfunduara dhe të parregullta në konturet e tyre, - për shkak se të gjitha gjërat bëhen më të vogla kur janë larg, detajet e imta të tyre zhduken plotësisht, e më pas edhe detajet më të mëdha nisin dhe zhduken, - në një largësi të madhe edhe konturet e formave janë të padallueshme. *Vazari,* biografi, thotë se Leonardo është nga ata *"që kanë natyrë gjeniale - ndonjëherë arrijnë më shumë, kur punojnë pak"* – mendja e tyre është e mbushur me idetë dhe përsosmëritë e tyre, të cilat konkretizohen në kryevepra, - **Keneth Clark** e quajti "Darkën e Fundit" të Leonardo Da Vinçit si *"guri i themelit për artin europian"* – në këtë pikturë Leonardo përdori *"perspektivën e manipuluar"* – ah, *Njeriu Vitruvian,* - Davidi kundër Goliatit, - *Guliveri* i Swiftit mbi botën, me optikë të përmbysur, të liliputëve, - *Njeriu Univers*, - vetë *Padre Nostro* i Mikelanxhelos, që i zgjat gishtin *Adamit* poshtë tij – ah , prekja e këtij gishti nuk ndodhi asnjëherë, - është një lëvizje drejt prekjes mrekullibërjes, por që mbetet pezull, nuk realizohet, është një mungesë në të Ardhmen, vetëm një përfytyrim, - jo një realitet, - *Erst Bloh: "e Vërteta mbart me qenien e saj madje dhe të paqenën e rrok krejt mundësinë e një qenie thuajse utopike"* – është e njohur thënia e *Aristotelit* se *Poeti* rrëfen të *Mundshmen,* jo *të Vërtetën*, - ai për ta përforcuar këtë e jep si shembull statujën e *Mytis*-it, - njeriu, që qe shkaktar i vdekjes së *Mytis*-it, duke e shikuar statujën, - befas e pësoi – se u sulmua nga statuja dhe u vra dhe vetë, - kjo statujë është padyshim dhe *Njeriu Vitruvian*, - në *Art* e *Vërtetë* bëhet e *Vërtetë* kur e kapërcen të *Vërtetën, - Artin e Krijon Pamundësia*, - Artin s'e gjen dot tek të rënit të tullës nga dora e muratorit, por tek mbetja e saj pezull në ajër, - dmth tek *Mrekullia...*

DIELLI NUK LËVIZ

-... *"Il Sole no si move"* ("Dielli nuk lëviz") këto fjalë të Leonardo Da Vinçit janë të shkruara me shkronja jashtëzakonisht të mëdha, në krye, në të majtë, të një prej faqeve të shënimeve, e cila është mbushur me skica gjeometrike, ushtrime matematikore, - një prerje e tërthortë e trurit, një vizatim i rrugës urinare të një mashkulli dhe zhgarravinat e një luftëtari plak, - kjo thënie këlthitëse, madhështore është dekada më herët se *Kopernikut* dhe *Galileut*, - kur e shkroi këtë frazë ishte viti 1510, - studimet mbi gjeologjinë e kishin bërë të ndryshonte mendje mbi vendin që zë planti i Tokës në sistemin Diellor, - *"Toka nuk është një qendër të orbitës së Diellit dhe as në qendër të universit" – Gjon Pagëzori*, - i pikturuar nga Leonardoja, - e ka dorën e djathtë me gishtin tregues të drejtuar nga qielli, duke treguar *Gjithçka* dhe *Asgjë* që është *Absolutja*, ose *Transcendentalja*, - duke nënkuptuar se Dielli nuk lëviz rreth Tokës, por e Kundërta – Amen!

PADUKSHMËRIA SI DUKSHMËRI

... Ç'mendon Historia, Historia (?) – pse *Arthur Rimbaud* në vend të së *Mundshmes* e vendos *"Kërkimin dhe nxjerrjen në shesh të së Panjohurës"* (?) – Artisti është një Lajmëtar, - pse piktori *Paul Klee* telajon e pikturës e mbush me dy shkronja dhe me një pjesë të Hënës (?) – *Pierre Bule* beson në *Pambarueshmërinë* e veprave të artit – a nuk ndodh kështu me Mona Lizën (?) – *Kavafi: "poezitë në të shumtën e herëve janë errësirë dhe kësisoj mund t'i përshtaten ndjenjave dhe gjendjeve të tjera"*, - *Abraham Molls* termat si imazh, parabola, simulimi, metafora, simboli etj., i sheh si një ëndërr të antikitetit latin, - ai ndalet më tepër tek parabola, të cilën mund ta quajmë si *rikrijim,* ringjallje të së qënës, - në një farë mënyre ripërtëritje dhe fshehje e së Vërtetës, ose një e Vërtetë më e vogël, në miniaturë, - a nuk është edhe Mona Liza një parabolë (?) – *Hoze Ortega Gaset: "njeriu përbëhet nga ajo që ai ka dhe nga ajo që ai humbet"* – pse *Keneth Clark* – e ka quajtur Leonardon *"mendja me kuriozitetin më të pakapërcyeshëm të historisë"* – *Giogio Vasari: "Ndodh që në mënyrë mbinatyrore, një personi të vetëm i dhurohet me bollëk nga qielli bukuri, hir, talent aq i madh, sa çdo vepër e tij është hyjnore dhe çdo që bën vjen jo nga arti njerëzor"* – *Steve Jobs* e arriti kulmin e shitjeve të shpikjeve të tij përmes një imazhi të shenjave rrugore, ku tregonte ndërthurjen e arteve liberale me teknologjinë, - Leonardo Da Vinçi ishte heroi i tij – *"Ai e shikonte bukurinë ne art ashtu dhe në inxhinieri – thonte Jobs – dhe aftësia e tij për t'i kombinuar të dyja ishte ajo që e bënte atë një gjeni"* – Leonardo *"fëmijë i paligjshëm"* (!) – edhe *Petrarka, Bokaçio, - Lorenco Xhilberti, - Filipo Lipi, Leon Batista Alberti* ishin gjithashtu *"fëmijë të paligjshëm, jashtë martese"* – Leonardo i paraprin metodës shkencore e cila do të zhvillohej një shekull më vonë me *Galileun* dhe *Bekonin*, - çdo të thotë të jesh "paraprijës" (?) – Leonardo hyri në një shpellë, - aty të ngulur në muret gurore të shpellës ai zbuloi fosilet e një balene dhe shkroi për të: *"O, ti instrument, dikur i gjallë dhe madhështor i natyrës, fuqia jote ishte e pakrahasueshme"* , - vërtetë në Toskanë në shtresat gjeologjike janë gjetur shumë fosile balenash, - ai shton *"ah, koha, grabitqare e shpejtë e të gjitha gjërave, sa mbretër, sa kombe ke rrënuar dhe sa ndryshime shtetesh dhe rrethanash kanë ndodhur që nga koha kur ky peshk vigan dhe i magjishëm u shua"* – si kureshtja ashtu dhe frikërat e tija do të shpreheshin në artin që Leonardo krijonte, si me përshkrimin e *Shën Jeronimit ilir*, të zhytur në agoni të plotë pranë grykës së një shpelle, ashtu dhe me vizatimet dhe përshkrimet e tij për *"një përmbytje të madhe apokaliptike"* – si mund të paralajmërosh *"homo europaeus"* – roli i kërkimit nuk është as të *hyjnizojë*, as të *zhgënjejë* – *Gëte:* "kur i kthehemi Historisë, dallojmë një dritë të re, - dalëngadalë kuptojmë përparësinë që kemi, - sepse kemi pasur paraardhës të shquar, ndikimi i të cilëve ka përshkruar kohërat, duke ardhur deri tek ne, - kështu dhe ne nga ana jonë bindemi se e kemi për detyrë të ndikojmë të Ardhmen me bëmat tona dhe në këtë mënyrë të bashkohemi në Të njëjtin Udhëtim të Lumtur me të tjerët" – nëse, në paraqitjen e saj estetike *gnosa* që mbështetet vetëm në artet pamore, tek letërsia dhe tek muzika, vuan prej mungesës, ose pamjaftueshmërisë së një shkence elementare të formave në formimin psikik të personalitetit, ajo mund të ketë pasoja shkatërrimtare, sidomos kur bëhet fjalë për *"njeriun problematik"*, - ta kërkosh lirinë në sferën e estetikës pa njohur strukturat e estetikës së parregullt të problematikës do të thotë – të marrësh parasysh shumë rreziqe, - në këndvështrimin shpirtëror, do të thotë t'u përshtatesh në mënyrë të pavetëdijshme proceseve thjeshtëzuese të një shoqërie *të teknicizuar*, - si pasojë, duke hulumtuar në mënyrë të vullnetshme ndërgjegjen në një çast meditimi, do të ndodhë që mos e konceptosh idealin e parregullt me aq forcë sa mund ta dëshirosh – kështu për atë, që dëshiron të kuptojë qartë shpirtin problematik të Europës, nxjerrja në dritë *"e të pavetëdijshmes"* prej historisë së nëndheshme të shpirtit europian, bëhet një ngjarje që hap një udhë drejt lirisë individuale – drejt një dialogu shumë më të drejtpërdrejtë me atë që mund të shprehet me numërorë, - në *Oviedo Asturia*, gjendet kisha Shën Salvator, që është ndërtuar nga princi *Silo*, - guri funeror i ktitorit të kësaj kishe mban një mbishkrim që ngjan me një kod të fshehtë, - duke u nisur prej mesit drejt katër cepave shprehja *"Silo princeps fecit"* mund të lexohet në 45760 mënyra, ahere Mona Liza e bërë (dmth fecit) nga Leonardo në sa mënyra mund të artikulohet me sy dhe me imagjinatë (?) – a nuk është një "Carmen labyrintheum" (?) – përcaktimet e germave me anë të ngjyrave i gjejmë edhe në disa sekte sekrete dhe të lashta të Tibetit – ahere si t'i kthejmë ngjyrat e Mona Lizës në germa tekstesh të pafundme të librave arketipalë platonianë (qiellorë) (?) – *Novalis: "Kuptimi i fshehur është mençuria e enigmës, apo arti për të fshehur thelbin nën vetitë e tij"* – poemat homerike janë tunika gjuhësore e Zotit, Zotit, - a është Mona Liza *"një cocktail verbal" (?)* – kur pikturon sfondin është pak tronditëse, pasi bimët janë kundërta me ç'ka bërë Leonardo në vizatimet e artit botanik në ditaret e tij, - botanisti *John Grimshaw* shprehet *"lulet nuk janë të vërteta, ato janë sajesa të çuditshme, p.sh. zymbyla të shpikur nga fantazia"* – e njëjta mospërputhje gjendet edhe në gjeologjinë – shkëmbinjtë e pikturuar nga Leonardo janë sintetikë, të ftohtë, me pamje groteske, - dihet prirja e Leonardos për "përzierjet gjinore", - për natyrën e mitizuar hermafrodite, - ai e pikturon kryeengjëllin Gabriel me fytyrë vajzore, - ai është i vetmi që bën kalimin nga *stili fiorentin* në *stilin milanez*, - për të është shumë gabim të flasësh për gjërat e kësaj bote në mënyrë absolute dhe pa dallim, apo,





si të thuash, duke ndjekur rregullin, sepse pothuaj të gjitha dallohen dhe bëjnë përjashtim për nga larmia e rrethanave, prandaj nuk mund të vlerësohen me të njëjtën masë dhe këto dallime dhe përjashtime nuk gjenden të shkruara nëpër libra, por nevoja na mëson maturinë – tek gjithçka është pesha e të rastësishmes, - paraqitja figurative varet jo nga imitimi apo iluzioni, por nga ngulitja – pothuajse çdo pikturë mund të paraqesë gati gjithçka – që do të thotë një pikturë e dhënë dhe objekti ka një sistem paraqitjeje, - një plan bashkëlidhjeje – nën të cilin piktura paraqet objektin – nëse paraqitja është një çështje zgjedhjeje, dhe korrektësia një çështje informacioni – realizimi është çështje zakoni – piktura fetare tregon fuqinë e plotë ontologjike të pikturës – sepse është krejt e vërtetë për shfaqjen e hyjnisë që ajo i fiton vetitë e saj pikturike – vetëm përmes fjalës dhe pikturës, - padyshim thotë *Hans-Georg Gadameri* një pikturë nuk është kopje e një qenie të kopjuar, por është në lidhje të ngushtë *ontologjike* me atë që kopjohet, - në artin budist gjëja e fundit që pikturohet janë sytë – kjo është *netra pinkama* ("ceremonia e syve") – kur artisti pikturon sytë – ahere është përfunduar krejt piktura dhe zotërohet nga kozmikja – legjitimohet statusi i përjetësisë së pakthyeshme me të artit piktorik – ah, *Invisibilia per Visibilia* – ("Padukshmëria si Dukshmëri")

Ç'THA VDEKJA?

... Ç'tha Vdekja, Vdekja? – Gjymtyrët skeletikë s'e prekin Leonardon, - futen tek Mona Liza si në boshllëk, në Hiç, në shurdhëri, në antimaterje, - ç'tha Vdekja, Vdekja? – Jam e *Gjithëmonëshmja,* e *Pafundmja* – përballë Mona Lizës s'arrij ta mohoj, as ta nënvleftësoj egërsisht, - përballë Mona Lizës, me humbet identiteti tmerrues, i tmerrshëm, - s'kam identitet, - pse tha James Joyce se për librat e tij duhej **"ideal reader affected by an ideal insomnia"**? – kriza në pikturë është njësoj si kriza në gjuhë dhe ndërsjellta të dyja krizat janë kriza të mendimit, - Jorge Luis Borges e kapërceu ndërtekstualitetin për t'i paraprirë hipertekstualitetit, - kush i përdor kulturat universale si gurët e lojës së shahut? - Ç'shkruan Dimitri Mereshkovski për Leonardo Da Vinçin? – një *science fiction?* – si mund të jem unë maksimalist kur Borgesi është minimalist? – Mona Liza s'është minimaliste! – Misteri e shumëfishon vetveten, - për asnjë të vërtetë tjetër nuk ishte aq i bindur Shpirti i Mesjetar sesa për fjalët e Shën Palit *"Videmus nunc per speculum in aenigmate, tunc facte ad faciem"* – Shpirti Mesjetar s'e ka harruar kurrë se do të ishte absurde çfarëdo gjë qoftë, nëse kuptimi i saj do të kufizohej tek funksioni i saj i atypëratyshëm dhe tek forma e saj si dukuri, dhe se të tëra gjërat nderen në një shtrirje të madhe, deri në botën e përtejme, - ah, **George Steiner: "unë vetë dua të jem një endacak, - jetoj sipas devizës të Baal Shem Tovit, - rabin i madh në shekullin XVIII: "e Vërteta është gjithmonë në mërgim"** – Kush e ka kërkuar të folurën adamike? – nëse *Georg Filip Hardorferi* në shekullin XVII pati pohuar se Adami s'mund të fliste veçse gjermanisht, - ahere ç'gjuhë amtare ka kështu Mona Liza? – apo është ajo që di misteriozisht *"gjuhën adamike"* – pse filozofi *Hajdeger* thonte se mund të filozofohet vetëm në gjermanisht, (shtonte edhe në greqisht)? – të kuptosh gjuhët njerëzore të papërsosura dhe në të njëjtën kohë të afta të realizojnë atë përsosmëri të epërme, që është Poezia, kjo përbën të vetmin përfundim të çdo kërkimi të papërsosmërisë, - Kulla e Babelit nuk është një rastësi, - jetojmë në Kullën e Babelit që nga Zanafilla, - dialogu i parë mes Zotit dhe Adamit ndoshta është bërë në *Finegonian* – vetëm duke u rikthyer në Kullën e Babelit, duke pranuar të vetmen mundësi tonën, mund të gjejmë paqen dhe të përballojmë fatin e racës njerëzore, - ah, Mona Liza që flet (në të vërtetë nuk flet,) në *Fineganian linguistikë*, - jetojnë të gjithë brenda *"Book of Kells",* - ose në *"Finnegans Wake"*, - në një strukturë, që nuk ka as qendër, as periferi, - pse Joyce i ri pyeti kur ishte student në kolegjin katolik se a do të kishte vlerë pagëzimi, nëse bëhej, me një mineral (?) – me çfarë ujë të shenjtë (konvencionalisht) u pagëzua vallë Mona Liza (?) – ah, epifania e një Gjithësie pa Bing Beng dhe pa Demiurg, - ah, Simboli është një epifani me mbretër Magë, - që s'dinë nga vijnë, ku shkojnë, dhe kë kanë ardhur të adhurojnë, - shpella e Betlehemit është e zbrazët, ose e zënë prej një objekti enigmatik: një thikë, një kuti e zezë, një kupolë kristali me dëborën që bije mbi Shën Marinë e Oropës, ose të një cope letre të grisur të orarit të trenave në një stacion që s'egziston asgjëkundi, - megjithatë flakëron, të paktën për ata (dmth për ne) që pranojnë *"Ftesën e Jothelbësores,* - pse në poemën "Waste Land" të *Eliotit* shkruhet: "pashë një që e njihja dhe e ndala, duke e thirrur *Stejston* (?) – pse Elioti dhe *Stejtsoni* kanë qenë të njohur (?) – pse *Stejtsoni* kish mbjellë në kopësht një kufomë që mbas ca kohësh kishte nisur të lulëzojë (?) – shpesh mënyra simbolike shfaq një logjikë të vetën të hekurt, megjithëse paranoike dhe simboli është i vrazhdë, gjeometrik dhe i rëndë si stela lapidar i galaktikës që shfaqet në sekuencat e filmit "Odisea në hapësirë" i Kumbrikut, - Çdo ligjërim përdor mënyrën simbolike, që çdo thënie të jetë e ndërtuar sipas *izotopisë të së pathënës,* - është herezia bashkëkohëse e dekonstruksionit, sipas së cilës një tekst (ose një pikturë si Mona Liza) thotë gjithmonë diçka të ndryshme, nga ajo që duket se thotë, e cila vepron sikur ndonjë hyjni, ose një pavetëdije e ligë të na bënte të flisnim vetëm dhe gjithmonë me *kuptime të dyta*, kuptime të shumëfishta, të infinitshme, dhe gjithë ç'themi të ishte pa thelb, sepse thelbësorja e ligjërimit (pikturimit) *qendron diku tjetër, tek simbolikja*, që shpesh s'e përfillim, - kështu thekson *Umberto Eco*, - xhevahiri simbolik, që duhej të të përndriste në terr dhe të na verbonte befas (mundësisht shumë më rrallë) është bërë një gjarpërushe neoni, që përshkron indin e çdo arti – nder i tepërt, - ah, jo të gjithëve u shfaqen zotat me qartësi të plotë – *enargeis* – thotë *Odiseu, - enargeis* – është *terminus technicus* për *epifaninë hyjnore,* mbiemër që mbart në vetvete shkëlqimin e së bardhës, - *argois,* por që në fund tregon një *"qartësi"* të pastër, të padiskutueshme, - ajo "qartësi" që u trashëgua nga Poezia dhe ndoshta, thotë **Roberto Calasso** *"e dallon nga çdo formë tjetër arti"* – ah, çdo Art, që refuzon të ecë përpara vëllazërisht me Shkencën dhe Filozofinë është një *Art Vrasës dhe Vetëvrasës,* - armik u shpreh *Kirshneri* (Athanasius Kircher) se "do të hap para syve tuaj Mbretërinë Shumëformëshe të *Morfeut Hiereoglofik, Teatrin Pantomorf* të Natyrës, të shpalosur nën perden alegorike të një kuptimi okult" (?) - Çdo vepër arti, - jo vetëm ti Mona Liza -, është një kremtim simbolesh, -, pajë ikonologjike të bëra prej imazhesh, që duken haptas se janë figura ëndërrash – kufoma të vërteta, të mirëfillta ikonike, - Parajsë e një psikoanalisti (- përshëndetje Frojd!) që s'ka për qëllim të lexojë në mënyrë shteruese Komentarin e tyre Fabulesk, onirik, plot premtime eliksiresh të koleksionistëve të *Absolutes*, - por nocioni ynë për Simbolin radikalizohet, - simboli refuzon të zbulojë absoluten e feve, por veç absoluten e *Poezisë,* - ah, Simboli, i helmuar sot nga Kultura bakteriale e *Dyshimit* dhe e *Komploteve*, - shkruhet vetëm për një *Lexues,* që s'është shuma e lexuesve, - i palumtur dhe i dëshpëruar është ai që nuk i drejtohet një *Lexuesi të së Ardhmes!*

QIELL I RI DHE TOKË E RE

- ... më kujtohet *Novalis* përsëri: tek e folura dhe tek e shkruara ndodh diçka e çmendur: bisedë e vërtetë është një lojë e pastër fjalësh, - duhet të çuditemi vetëm nëse njerëzit besojnë se dinë të flasin si duhet për gjërat – pikërisht atë që ka të veçantë gjuha: kujdesin ndaj vetvetes, - të gjithë e shpërfillin, - prandaj ajo është një mister kaq i mrekullueshëm dhe kaq i frutshëm deri në atë pikë, sa, nëse ndonjëri flet sa për të folur, shpreh të vërtetat më origjinale dhe të pabesueshme, - por nëse do të flasë për diçka të përcaktuar, gjuha tekanjoze shpesh i bën të thonë gjëra më qesharake dhe të shrregullta, - prej këtij buron edhe urrejtja që kanë disa njerëz seriozë ndaj gjuhës – sikur të mund të bëhej e kuptueshme për njerëzit se me gjuhën gjërat janë si me formulat matematikore – të cilat përbëjnë një botë më vete – luajnë vetëm me veten e tyre, nuk shprehin gjë tjetër veçse natyrën e tyre të jashtëzakonshme dhe pikërisht për këtë janë kaq shprehëse – pikërisht për këtë ato reflektojnë loja e çuditshme e lidhjes së gjërave, - veç nëpërmjet lirisë së tyre ato janë artikulime të natyrës dhe vetëm në lëvizjet e tyre të lira manifestohet shpirti i botës dhe bën me to një masë delikate dhe një profil të gjërave, - por në ç'raport poliform është e folura dhe gjuha me Mona Lizën si emër dhe mbiemër i linguistikës (?) – oh *Niçe, Niçe: "ç'është metafora? – një ushtri e lëvizshme metaforash!"* – instinkti themelor i njeriut është instikti për të formuar metaforat, - *Niçe, Niçe* i jep artit një cilësi të lartë gnosologjike, - ku njohuria dhe simulimi nuk janë më antagoniste, por bashkëpunim, - vetëm me vdekjen, ve në dukje *Karl Rahner*, pushon *status viatoris* i njeriut, - realja shfaqet si mundësi e papërcaktueshme, pre e kolapseve kuantike të befasishme, që zhdukin disa pjesë prej saj, të përpira, të përthithura në vorbullën hapësirë – kohë, mullinj të vdekshmërisë së të gjitha gjërave, por dhe të lindjes së paparashikueshme të jetës së re, - udhëtimi në hapësirë është edhe udhëtim në kohë (dhe kundër kohës) – ne jemi kohë e ngjizur, - jo vetëm një individ, por edhe një vend është kohë e ngjizur, - kohë shumëfishe – "pse po sillemi këtyre anëve me kalë? – e pyet flamurmbajtësi markezin, që ecën përkrah tij në baladën e famshme të *Rilkes,* - "Për t'u rikthyer rishtas", i përgjigjet ai," – *ne largohem, ikim, mërgohemi nga Mona Liza – vetëm e vetëm për t'u rikthyer...* - jeta – kur nuk është vuajtje – është lojë, - universi është një farsë e mendjes, - apo mendja është farsa e universit, - çfarë është syri (?) – organ i sipërfaqshmërisë së përjetshme – kërkim i proporcionit, teksa frika e mungesës së proporcionit përcakton babëzinë e tij për konture të vëzhguara, dmth arkitekturë e zbukuruar sipas Imannencës, - pikturë e brendshme dhe peizazh, - pa sugjestionimit në largësinë të pambritëshme, - muzikë e hijeshisë së pranueshme dhe e ritmit të matur, po aq sa edhe e shprehjes së proporcionit, e mohimit të pafundësisë, - shija është bukuri e peshuar, edukuar përmes stërhollimit kategorik – stili është arkitektura e mendimit – e mendjes, - s'duhet të kemi për kulturën entuziazmin e lehtë dhe të

(vijon në faqen 17)

NËPËR UDHËN E DASHURISË – HAJKU NGA NASHO JORGAQI

nga Giuseppe Schirò Di Maggio



Nasho Jorgaqi është Poet dhe këtë emër me "P" të madhe e ka fituar me gjashtë botime me hajku (një poezi e shkurtër me origjine japoneze): *Nën hiret e bukurisë* (2005), *Nën zë* (2010), *Momente* (2007), *Pëshpëritje* (2016), *Zgjime shpirtërore* (2018) e, i tanishmi, *Nëpër udhën e dashurisë* (2019).

Më 2005-n, kur sapo doli libri i parë me hajku i poetit tonë, mendova: "Nasho po na bën konkurrencë!". Dhe me të vërtetë, pas pesëmbëdhjetë vjetësh nga dalja e librit *Nën hiret e bukurisë*, Jorgaqi është poet i mirënjohur, i lexuar e i admiruar, tashmë edhe i përkthyer në dy botime në greqisht (*Duke rrokur vetëtimat* (2011) dhe *3x17x3* (2015)).

Me hajkun kuvendohet për dashuri apo, më mirë, bëhet dashuri. Në mënyrën japoneze, ku çdo gjë e bukur këndohet e dashurohet - që nga bukuria femërore, si i pari arsyetim universal dashurie, tek natyra e ndritshme në lulet e qershive apo dëgjimi i gurëve që hedhin shtat - gjendemi në brendësinë e atomit të shpirtit të njeriut lindor japonez. Një mësim i bukur jete dhe letërsie.

Përtej Adriatikut, jo shumë larg Shqipërisë, gjejmë, gjithashtu, një poezi të lindur thuajse tetëqind vjet përpara, që lëshon në shprehjen poetike fjalë të reja, "të sapogjetura", me prejardhje nga latinishtja, por tashmë me fizionomi të vetën: *Rosa fresca aulentissima ch'apari inver' la state, / le donne ti disiano, pulzell'e maritate.* (Trëndafil i freskët plot aromë që del në muajt verorë, / gratë të dëshirojnë, vashëza e me kurorë) e *Cielo d'Alcamo*-s nga Shkolla Siciliane. Kjo e fundit bashkon një grup interesant poetësh të rinj, që marrin pjesë në lindjen e gjuhës italiane, e që do të pagëzohet në Toskanë me emrin "Il dolce stil novo" (I ëmbli stil i ri).

Një parantezë e shkurtër si për të thënë se pikërisht "Të ëmblit stil të ri" dhe Dantes u referohet Nasho Jorgaqi në përmbledhjen e tanishme me hajku. Mu në faqen e kushtimit del një citat nga një vjershë kuptimplote e Dantes, nxjerrë nga *Vita Nuova* (VII, 3-6): *O voi che per la via d'Amor passate!* (O ju, që nëpër udhën e dashurisë kaloni). Ky fill i artë, që lidh disi poezinë e autorit tonë me atë të "Dolce stil novo", mund të përmblidhet, sa i përket përmbajtjes, në vargun sublim 100 të Këngës V të Ferrit dantesk, kur Françeska në mënyrë universale shpreh rënien njerëzore në dashuri: *Amor ch'al cor gentil ratto s'apprende...* (Dashnia, n'shpirt fisnik që hyn aq letë – përkthyer nga Pashko Gjeçi). Kurse për formën e vargëzimit ajo i referohet ngjeshurisë së hajkut japonez. Më duket një provë e qëlluar për të thënë se poezia nuk njeh kohë dhe hapësirë gjeografike. Ajo është e përjetshme si Shpirti Hyjnor, që "fryn" kurdo e kudo.

Hajku i Jorgaqit ka origjinalitet. Duke marrë shkas nga ai japonez, Jorgaqi e shndërron dhe e përshtat me kërkesat e tij shprehëse. Forma e hajkut japonez ka rregulla të mirëpërcaktuara. Ai përmban tri vargje, ku i pari dhe i treti kanë gjatësi të njëjtë, ndërsa i dyti mban dy rrokje më shumë: 5-7-5. Hajku i Jorgaqit respekton tri vargjet, por jo gjatësinë e tyre. Vargu i përshtatet lirisht ndjenjës nga është frymëzuar, si dashurisë e mallit, por njëherësh është i mbushur me sentenca, urtësi e mendime didaskalike. Edhe poetë të tjerë që vargëzojnë me hajku, ndër të cilët poeti shqiptar Milianov Kallupi, përdorin vargje me gjatësi të ndryshme, duke mbajtur natyrisht tri vargjet e hajkut klasik.

Hajkuja e parë e librit *Nën hiret e bukurisë* (2005) këndon: "Bukur ta sodisësh sythin / tek shpërthen e çel degë / dhe er'e lules bëhet fryma jote". Natyra e jetës bimore bëhet fryma e gruas, por në atë libër programi i dashurisë dhe i rënies në dashuri fillon nga hajkuja e dytë: "Të duash në dhimbje /dhe dhimbjen të mos e tregosh / Ja forca e heshtur e dashurisë". Që në fillim gjejmë sistemin sentimental, intelektual, poetik që Jorgaqi do të zbatojë në librat e tjerë me hajku. E pranishme në të gjithë librat, por sidomos në atë të sprasmin, *Nëpër udhën e dashurisë,* është urtësia e moshës së pjekur dhe ankthi i kohës që shkon: "Vitet ndjekin njeri-tjetrin /kurrë s'i ndalojmë dot. / Utopia e ëndrës njerëzore".

Të këndosh dashurinë në çdo moshë: me rrëmbim në djalëri, me ëmbëlsi në pleqëri e me hidhësirë për sa mund të kish qenë e nuk qe. Në hajkutë e tij kjo ndjenjë është e pranishme. Megjithatë, edhe plaku, kur shkruan vargje, nuk ështe vërtet plak, sepse edhe ai bëhet fëmijë: "Ti nuk do të ishe poet / pa qenë dhe pak femijë / kur shkruan vargje" (f. 69). Më vjen në mendje një shprehje, që nuk e kujtoj kush e ka shkruar: "Të bëhesh fëmijë duhet plot një jetë e tërë". Sepse para dashurisë dhe para gruas, që i jep substancë dashurisë, ne të çdo moshe bëhemi të gjithë fëmijë dhe thurim poezi. E thotë edhe poeti francez *Alphonse Daudet*: "Një poet është një njeri, që e shikon botën me sytë e një fëmije".

Pse Nasho Jorgaqi citon Danten në faqen e parë të librit me hajku: *O voi che per la via d'amore passate*? (O ju që nëpër udhën e dashurisë kaloni?). Në thelb, a është gruaja "angelicata" (ëngjëllore), që këndon "Il dolce stil novo" e natyrisht Dantja, gruaja e kënduar nga Jorgaqi në hajkutë e tij? A është gruaja që zbret nga qielli në tokë "a miracol mostrare" (të dëftojë mrekulli)? Në të stërmadhen larmi të hajkuve të tij mund të gjejmë shprehje të lidhura me idenë e sublimimit ose të transhendencës së figurës femërore: "Aq e bukur ishe atëherë / sa sipas fytyrës tënde / vezullonte imazhi i Zotit" (f. 88).

Unë mendoj se gruaja e kënduar nga Jorgaqi është gruaja moderne, e ditëve të sotme, domethënë e miturisë sonë, e djalerisë sonë, e pjekurisë sonë, e pleqërisë sonë. Poezia e tij e bën gruan herë "angelica", herë problematike, herë mllefqare dhe përçmuese (" Më kot i shtrive duart drejt' saj / kur ajo pa fjalë shpinën ta ktheu / dhe të bëri të flasësh me vete"! (f. 101)), herë të ëmbël e herë nxitëse për ankthin e kohës që kaloi dhe që kalon në mënyrë të pashmangshme. Por Jorgaqin duket se e tërheq edhe gruaja "inteligjente", e mençur! Dhe nëse shfletojmë Danten (Vita Nuova), kryeradha na e shpjegon: "Donne ch'avete intelletto d'amore..."! Të mençura, për veten e tyre, por sidomos "inteligjente" të pranojnë propozimet e dashurisë.

Një jetë e bukur dashurie ajo e poetit Jorgaqi, jetë da-



shurie shkruar dhe kënduar qysh në fillim të karrierës së tij të shkëlqyer letrare. E, me të vërtetë, vetëm nga titujt e librave të botuar, spikat frymëzimi i tij poetik, edhe kur shkruan në prozë: nga libri i parë, *Dashuria e Mimozës* (1960), pastaj Ëndrra dhe *plagë* (1963), *Manastiri i dashurisë* (1995), *Ndëshkimi i bukurisë* (1998), *Shpirti i magjepsur* (2001), *Ishte një herë një dashuri* (2003), *Netët e bardha të dashurisë* (2005), *Dashuria nën qerpikë* (2015, *Zemër* (2017). Këtyre shkrimeve për dashurinë ("dashuria" është fjala më e përsëritur) duhet t'u shtojmë edhe librat e lartpermendur me hajku.

Përmes viteve shihet, megjithatë, një ndërprerje, një cezurë, që nis nga viti 1963 dhe arrin në vitin 1995. Është cezura dhe censura (për autorin tonë, me gjasë, vetëcensura) e periudhës së monizmit. A mund t'i këndohej asokohe dashurisë? Nga lajmet e pakta që kam, kush shkruante poezi dashurie o melankolie o thjesht përshkruese pa program shtetëror, mbahej si poet dekadent, me pasoja disa herë të rënda. Më pëlqen të kujtoj një poezi ndriçuese të Dritero Agollit, *Dy fjalë poetëve që vijnë*, e cila këndon kështu: "Ne s'kemi pasur aq kohë të shkruanim për dashurinë, / megjithëse kemi qenë dashnorë të marrë. / [...] / Vendi kërkonte nga ne poetët e shkretë / të drejtonim kurset kundër analfabetizmit, / të ngrinim diga në lumenjtë, / të ndiznim maleve llambën e socializmit. / Ndaj mos u çudisni, ju poetë që vini në jetë, / dhe mos na qortoni për ato që s'bëmë. / [...] Vallë dy vargje për dashurinë s'mund të kishim grirë / dhe s'mund të kishim belbëzuar: Oh, moj belkëputura? / [...] Të na kishit parë si digjeshim pranë vajzave që donim! / Ç'fjalë të bukura u thoshim në mbrëmjet e arta! / Po ne s'kishim kohë që fjalët e bukura t'i botonim / dhe shtypshkronjat i kishim për gjëra më të larta...".

Në thelb, shteti që kontrollonte si kulturën si shtypin, kish të tjera të mendonte! Nasho Jorgaqi "i devijoi" shkrimet e tij të asaj periudhe: prodhoi libra për estetikë, biografi, libra historikë, duke iu kushtuar njëherësh punës së tij si profesor universiteti. Në kushtimin e librit të tij të fundit me hajku Jorgaqi shkruan, duke rimenduar ndoshta për sa mund të kish qenë, por që pjesërisht nuk qe: "Ia kushtoj brezit tonë letrar të viteve '60 të shekullit XX, për zërat solistikë dhe kontributet e çmuara që sollën në letërsinë shqipe".

Mbiemri "solistikë" më duket se tregon mirë realitetin e kohës, të epokës së "seriozitetit socialist". "Solisti", pra, ai që këndon i vetëm, bën poezi mendore, por u bindet ligjeve të shtetit, që ndalon disa shprehje artistike të mbajtura si të rrezikshme. Vërtet janë këto gjëra që të bënin të rrënqetheshe asokohe e të bëjnë të rrënqethesh edhe sot, por çfarë tjetri mund të gjeje, në koha nuk ish ende e pjekur për liri?

Tema tjetër e madhe e këtyre librave me hajku është ndjenja e kohës që ikën, e moshës së tretë o të katërt, që afrohet pashmangshmërisht. Dhe është e trishtueshme të mos shijohen si më parë bukuritë e natyrës në përgjithësi dhe ato femërore në veçanti: "Çdo të bësh tani me hirin / e dashurive të fikura / kur po të ftoh pleqëria?" (f. 97).

Dashuria për të cilën poeti *bie në dashuri*, rrjedh nëpër mijëra e mijëra vargje. Dhe me dashurinë ai ngjitet gjithmonë më lart, sic ngjitej gjithmonë më lart Dante Aligieri në udhëtimin e tij jashtëtokësor përshkruar në Komedinë Hyjnore. Dantja mbyll nga pika më e lartë e gjithësisë me apoteozën e dashurisë, atë hyjnore: *L'amor che move il sole e le altre stelle* (Parajsa, XXXIII, v. 145) (Dashnija, / që lëviz diell e yj të vezullueshëm - përkthyer nga Pashko Gjeçi). Edhe Nasho Jorgaqi në një hajku ngjitet lart, duke përmendur Perëndinë me një arsyetim, që është krejt një simfoni e krishterë: "Pse t'i lutemi Zotit? / T'i lutemi dashurisë / që zbret Zotin në tokë".

Për çdo hajku të librit *N*ëpër udhën e dashurisë, por edhe të botimeve të tjera, duhet të shkruheshin faqe komentesh dhe përsiatjesh. Lexuesi i mirë do t'i shijojë, do t'i komentojë dhe përvetësojë tercinat moderne të kësaj poezie, të shpirtit gjithmonë rinor dhe të urtësisë nga përvoja e një jete të gjatë, që si tufëza lulesh pranverore na vijnë nga poeti Nasho Jorgaqi.

(vijon nga faqja 15)

ndryshueshëm të injorantëve – sepse gëzon të gjitha përparësitë e irealitetit, - e duam natyrën por jo dhe aq peizazhin e humanizuar nga njerëzit e shtëpisë – sublimja është kategori e muzikës – (Mona Liza vetëm sublime nuk është) – kush nuk është tronditur nga pafundësia e tij rreme (?) – Leonardo Da Vinçit është mjeshtër i detajit – një arnues i hollë i fragmentit, - të jesh sipërfaqësor në stil është më "e vështirë" se të jesh i thellë, - kultura është nuancë, thellësi, intensitet – mungesa e së ardhmes është substanca e së tashmes, - ndjeshmëria rritet si bimë, - dekadenca është e kundërta e epokës së madhështisë: është ritransformimi i miteve në koncepte – shterimi shpirtëror çon në mumifikimin e një kulture - ç'është një qytetërim (?) – një roje grifon i dritës që të mos shuhet – një peizazh i *Mone*-së – që e shteron poezinë e dukshme – e përmbush këtë gjë, - një frymëzim pa mëgojza është Mona Liza – leximi i poezisë dhe meditimi për Mona Lizën janë Arti i Deshifrimit, - efektet estetike nuk kanë gjithmonë një rezultante, - ah, miti pagan i *Pandorës,* - gruaja e parë e gjinisë njerëzore, - perëndit e dhanë dhurata: Atena i dha mençurinë, Hermesi i dha gojëtarinë, Apoloni talentin për muzikë dhe për vargje poetike, - *Epimeten,* i vëllai i *Prometeut*, - u martua me Pandorën e mrekullueshme, - por në shtëpinë e Epimetent ishte një *Kuti e Mbyllur e Zeusit*, - që s'duhej ta hapte askush, - a nuk kemi këtu Arketipin Jahovian - e *Mollës së Ndaluar* – të frutit ,-që kush e shijonte fitonte të tëra dituritë (?) – tabuja e Kutisë së Mbyllur – qe një mallkim, frikë ndaj Zeusit totalitar, tiran, - Pandora u bë kurioze, - kurioziteti është formë e *Lirisë* dhe *Njohurisë* – e hapi *Kutinë e Mbyllur* – prej saj dolën gjithë të këqijat dhe mjerimet që do ta hidhëronin gjininë njerëzore – a nuk qe ky *Mëkati Fillestar* dhe i dëbimit të *Evës* dhe *Adamit* nga *Kopshti i Edenit* (?) – a nuk vazhdon akoma padrejtësisht Mallkimi brutal i gabuar, hakmarrje psikopatike, e padrejtë (?) – "u dënua" barbarisht, idiotësisht më tepër Pandora – më e bukura dhe më fisnikja sa tërë zotat sëbashku madje edhe mbi Zeusin, se sa Prometeu i cili e sfidoi Zeusin, - a nuk ngjan miti i Pandorës me vetë Mona Lizën enigmatike, - a nuk e sfidoi me Mona Lizën Leonardo Da Vinçi tërë krishterimin dhe vetë *Mëkatin Fillestar*, - për ta rikthyer Evën dhe Adamin përsëri në Kopshtin e Edenit (?) – a nuk ishte Pandora gruaja me bukuri më të jashtëzakonshme – a nuk është amshuar Mona Liza pikërisht nga bukuria e saj e jashtëzakonshme (?) – Bukuria i përballet me sukses rebelimit ndaj zotave të të tëra feve, - që janë forma të nënshkrimit dhe të skllavërisë shpirtërore, - ah, *Pandora Mona Lizë* – ah, *Mona Liza Pandora* – ah, Pandora si *Liria në barrikadë e Delakruasë*, - Rebelimi i Njerëzimit, - për një *Qiell të Ri dhe një Tokë të Re...*

EPIFANIA E ZGJIMIT TË BUKUROSHES SË FJETUR

- ... pse *E. H. Gombrich* shpalli (si *Sibilia e Kumes): "art në vetvete në të vërtetë nuk ka, - ka vetëm artistë"* (?) – a nuk është njëlloj si të thuash *"nuk ka artistë, ka vetëm art"* (?) – kështu *Xhoto (Giotto)* pikturon një matronë me krye me njërën dorë dhe pergamenë në tjetrën, - shihet qartë se pikturë afresku ngjason me veprat e skulptorëve gotikë, por piktura nuk është statujë, - por është e vërtetë se piktura të lë përshtypjen e një statuje, - aty shohim *rakursin* e krahëve, modelimin e fytyrës dhe të qafës, hijet e thella të palëve të drapërisë, - diçka e tillë nuk është bërë prej mijëra vitesh, - Xhoto kështu kishte zbuluar (rizbuluar) artin e krijimit të iluzionit të thellësisë në një sipërfaqe të rrafshtë, - për Xhoton ky zbulim (rizbulim) nuk ishte mjet për hir të mjetit, por një risi, që i mundësoi të ndryshojë tërë konceptin (konceptualitetin) e Pikturës, - në vend që të përdorte teknikën e ilustrimit me piktura, ai arriti të krijojë iluzionin se kjo histori e shenjtë po ndodhte (live) përpara syve



tanë – por Piktura për Xhoton, nuk është aspak zëvendësim i fjalës së shkruar, - ? është një paralele, ndërsa *Piktura Universi i Dytë,* - nëse Xhoto është bashkëkohës i poetit të madh *Dante,* - i cili e përmend atë tek "Komedia Hyjnore" *Simon Martini* është miku i *Petrarkës*, poeti më i madh italian i brezit pasardhës, - mes piktorëve italianë enigmatik dhe i papërballueshëm u shfaq "fëmija i paligjshëm" Leonardo Da Vinçi, - me alergji ndaj njohurive libreske të dijetarëve sikurse më vonë *Shekspiri "dinte pak (ose aspak) latinisht dhe pak (ose aspak) greqisht"* – ndoshta kujtojnë "Ëndrrën e një nate vere" të Shekspirit dhe rolet që ai u jep Sharrës *marangoz*, Ngordhalaqit *rrobaqepës*, Turirit *kazanxhi*, ahere mund të kuptojmë sfondin e muzgëtuar e kësaj lufte të jetës – Aristoteli kishte kodifikuar snobizmin e lashtësisë klasike, e cila artet i ndante në "arte që pajtoheshin me një shkollim të edukimit liberal" – të ashtuquajturit *"Arte Liberale*, (si gramatika, logjika, retorika, gjeometria,) dhe atyre punëve e pasioneve që përfshinin punën me dorë, të cilat ishin "fizike", - prandaj dhe "shërbyese" dhe kësisoj në nivelin e dinjitetit të një fisniku, - por ambicia e pakufishme e Leonardo Da Vinçit ishte të *provonte* se *Piktura* është *Art Liberal* – ndonëse punohej me dorë, - por qe edhe ndryshe nga puna me dorë e të shkruarit të Poezisë, - Kjo nënkupton edhe shpesh se Leonardo mbiquhet, titullohet si "shpikës, ingjiner" dhe nuk ngriti asnjëherë një punishte pikture ku të mblidhte dhe dishepuj artistë, - askush nuk ka qenë më i duruar në vëzhgimin dhe imitimin e natyrës si *Van Eyck,* - por Leonardo pikturon mistikën e pamjeve, - pra është një *Metafizikant i Madh*, - Leonardo si në përrallën e famshme që i ka ngrirë gjestet, lëvizjet, pozicionet e njerëzve dhe drurëve në Çastin e *Bukuroshes së Fjetur* në pritje të epifanisë së kthimit (rikthimit) të të tëra lëvizjeve, të çgurëzimit universal, e krijoi mes nesh *Mona Lizën*, - pra një Kips të *Bukuroshes së Fjetur*, - një klonim të tjetërsojtë, - tërë komentuesit e zellshëm dhe rutinorë presin një zgjim nga gjumi magjik, por janë përherë në mes – në moszgjim dhe në një *Ardhmëri Zgjimore* – padyshim ka dhe shpirtra të këqij mbi vetë Mona Lizën, - a nuk qe dikur *Derrida* një shpirt i keq në funeralin e *Marksit* (?) – kyçi i postmodernes është se ekzistojnë dy *"të tashme"*, - një është *"e tashmja"* fantazmë një realitet virtual, - *simulacrum*, - tekno-mediatik, që e bën të "tashmen" tjetër "reale" të duket si pa kufi, që ikën, e pakapshme, - dhe ky dematerializim i reales është një Bibël Postmoderne, - jo më kot para vdekjes (në 1984) *Foncault* bëri thirrje për një rikthim (ridimensionim) të *Iluminizmit,* - për një filozofi të *"Rrëfimeve të Mëdha"* të Njerëzimit, - për një *Terapi Homeopotike,* - kjo do të thotë se Mona Liza është dhe mbetet *Grifoni Mbrojtës* i *"Rrëfimeve të Mëdha"* – nëse do të humbasin:, *"Rrëfimet e Mëdha*" s'do të ketë në jetë të jetëve as Mona Lizë... oh, *Derrida, Derrida*, - nuk është korrekt supozimi se gjithçka *e arsyetuar* është gjithmonë universale, pa kohë, dhe e qëndrueshme, - çdo kuptim, ose identitet (përfshirë dhe tonin) është i përkohshëm dhe relativ, - sepse nuk është asnjëherë *shterrues*, - gjithmonë mund të gjurmohet prapa, - deri tek një rrjet i mëparshëm i dallimeve, por edhe para natyrisht, gati në pafundësi, ose në *"shkallën zero"* të kuptimit – ky është *dekonstruvizmi* – ku i qërohen si një qepe shtresat e kuptimeve të mbivendosura, - kjo është hullia e një strategjie të zbulimit të kuptimshmërive të fshehura, - tekstet (ose dhe veprat e artit) nuk janë asnjëherë unitare, por përfshijnë burime, që shkojnë shpesh edhe kundër shprehjeve por dhe synimeve të autorëve (artistëve) të tyre – kuptimi përfshin *identitetin*, - (çka është ai) dhe *dallimin* (çka nuk është) dhe prandaj është vazhdimisht duke u *"deferred"* – *Derrida* e shpiku këtë fjalë për këtë proces, duke kombinuar *dallimin* (difference) dhe *shtyrjen* (deferred), - shtyj, largoj, veçoj), - *Derrida* është përpjekur të nxjerrë përfitime pozitive nga dështimi delizionues i meta-gjuhës strukturaliste, - duke vepruar kështu Derrida e la veten të hapur ndaj akuzave për *relativizëm* dhe *irracionalizëm...*

PROTOTIPI I ANA KARENINËS ISHTE VAJZA E PUSHKINIT

Përgatiti dhe përktheu Bujar Hudhri

Më 29 mars 1873, shkrimtari i famshëm rus filloi punën mbi romanin "Ana Karenina". Prototip i Ana Kareninës ishte vajza e madhe e Pushkinit, Maria Hartung. Në të vëtetë, ajo nuk u hodh poshtë trenit, madje jetoi edhe nja dhjetë vjet më shumë se Tolstoi derisa vdiq në Moskë, më 7 mars 1919, në moshën 86 vjeçare.

Në fillim të vitit 1868, në shtëpinë e gjeneralit Tulubiev, Maria Aleksandrovna u njoh me Lev Tolstoin, cili më vonë do të pasqyronte tiparet e pamjes së jashtme të saj në romanin "Ana Karenina". Kunata e Tolstoit (motra e gruas së tij), Tatiana Kuzminskaja, e përshkruan kështu këtë takim në librin e saj me kujtime "Jeta ime në shtëpi dhe në Jasnaja Poljana":

"Kujtoj një mbrëmje te gjenerali Tulubiev.

Karantina e skarlatinës kishte përfunduar. Sonja [Sofia Tolstaja] ende nuk vinte tek ne, ndërsa Lev Nikollajeviçi na vizitonte shpesh. Një herë ai erdhi dhe ndenji të kalonte natën. Ne ishim të ftuar në një mbrëmje tek Tulubievët.

-Eja me ne, - i thashë,- se ti njihesh me gjeneralin, kurse Luiza Karlovna është një yll i bukur: e edukuar, muzikante e mrekullueshme dhe një grua tepër e dashur.

- Aq shumë sa po e ngre në qiell, shkojmë pse jo,- tha ai.

Tek Tulubievët gjetëm një shoqëri mjaft të madhe. Shumë prej tyre Lev Nikollajeviçi i njihte: Fjodor Fjodoroviç Mosollov, një çifligar i pasur dhe një rritës i njohur kuajsh, kontin Lvov, që kishte qenë në Jasnaja dhe plot të tjerë.

Ishim ulur përreth një tavoline çaji të stolisur me shije. Kosherja mondane fillojë të gumëzhijë: po më vinte keq që nuk ishin Arsenjevët, veç kur u hap dera e paradhomës dhe hyri një zonjë e panjohur me një fustan të zi me dantellë. E ecura e saj e lehtë e bënte të lehtë figurën e saj mjaft të plotë, por të drejtë dhe elegante.

Më prezantuan me të. Lev Nikollajeviçi ishte ulur ende në tavolinë. E pashë se si ia nguli vështrimin asaj.

-Kush është kjo?- më pyeti duke u afruar.

- Madame Hartung, bija e poetit Pushkin.

- Aha - zgjati zërin ai,- tani e kuptoj... Pa shiko se çfarë kaçurrela arabe ka në zverk.

Kur e prezantuan Tolstoin me Maria Aleksandrovnën, ai ndenji tek tavolina e çajit, pranë saj. Se çfarë biseduan unë nuk e di, por di që ajo i shërbeu atij si prototip për Ana Kareninën, jo me karakterin, jo me jetën, por me pamjen e jashtme.

Ai vetë ma ka pranuar këtë fakt.

Kur po ktheheshim në shtëpi, ishim në qejf. Nuk lamë askënd dhe asgjë pa përmendur, pastaj gjeta rastin dhe bëra shaka:

-E di që Sonja do të ishte bërë xheloze me ty për Hartungun.

-Po pse ti, nuk do ta kishe bërë Sashën xheloz?

-Patjetër.

-Epo, edhe Sonja po ashtu, - m'u përgjigj duke qeshur.

Mëngjesin tjetër u largua për diku më tej; e kam harruar se ku."

Sipas shumë versioneve Tolstoi iu vardis më kot Marias, dhe ngaqë mori refuzimin e saj, i përgatiti atë fat të keq heroinës së librit.

Le të shohim fragmentin ku shkrimtari i madh përshkruan Ana Kareninën në roman, duke u mbështetur tek figura e Maria Aleksandrovnës:

"Ana nuk kishte veshur fustan ngjyrë jargavani…

…Në flokët e saj të zinj, ku s'kishte asnjë fije floku të rremë, kishte një kurorëz vjollcash dhe një kurorëz tjetër të tillë e kish citosur në kordelen e zezë të belit, mes dantellave të bardha. Flokët e saj dukeshin sikur qenë krehur pa ndonjë kujdes të veçantë, por ajo që binte në sy, ishin kaçurrelat e vegjël lozonjarë që i binin te zverku e tek tëmthat edhe ia zbukuronin fytyrën. Në qafën e bukur si të skalitur kishte varur një varg me margaritarë."

(Sipas përkthimit të Vedat Kokonës, "Ana Karenina", Vol. I, faqe 91, Botimet Kokona, Tiranë, 2006)

Por Tostoj i detyrohet Pushkinit jo vetëm me figurën e Anës, por edhe me fillimin e romanit. Biografi i Tolstoit, Pavël Birjukov, për këtë fakt shkruan: "Tezja e Lev Nikollajeviç Tolstoit dergjej e qetë në krevat ku po kalonte ditët e saj të fundit, pasi ishte e sëmurë, kurse i biri i Lev Nikollajeviçit, i lexonte asaj një libër të Pushkinit. Tezen e kishte zënë gjumi, kurse libri mbeti mbi tavolinë. Në këtë kohë hyn Tolstoi, e merr librin



Botimi i parë i Ana Karenina

në dorë dhe lexon; "Mysafirët u mblodhën në vilë. Salla u mbush me dama dhe burra, që kishin ardhur në një kohë nga teatri, ku jepej një opera e re italiane." Një fragment krejt i shkurtër dhe Lev Nikollajeviçi flet: "Ja si duhet filluar! Një tjetër do të niste me përshkrimin e rrethanave, kurse Pushkini shkon drejt e te veprimi". Më tej biografi Birjukov shkruan se, Tolstoi shkoi në kabinet dhe shkruajti frazën e njohur: "Punët ishin si mos më keq në familjen e Obllonskëve" e cila gjysmë viti më pas do të zëvendësohej nga fraza e famshme me të cilën nis kjo kryevepër e letërsisë botërore: "Të gjitha familjet e lumtura i ngjajnë njera tjetrës, çdo familje fatkeqe është fatkeqe ndryshe nga të tjerat." (Sipas përkthimit të Vedat Kokonës)

Në ditarin e saj, gruaja e shkrimtarit, Sofija A. Tolstaja ka shkruajtur: "Serjozha (bëhet fjalë për djalin e tyre të parë, Sergej Lvoviç Tolstoi) këmbëngulte që t'i jepja një libër që t'ia lexonte me zë tetos plakë. Unë i dhashë "Novelat e Bjellkinit" [Bëhet fjalë për librin me novela të Pushkinit "Novelat e të ndjerit Ivan Petroviç Bjellkin"]. Por tezen e zuri gjumi dhe unë, ngaqë përtoja të shkoja poshtë, për ta vënë librin në bibliotekë, e lashë te dritarja e dhomës së pritjes. Të nesërmen në mëngjes, kur po pinim kafe, Lev Nikollajeviçi e mori këtë libër dhe filloi ta shfletojë dhe të mahnitej".

Ndërsa djali i madh i Tolstoit, Sergej Lvoviç shkruan në librin e tij me kujtime:

"Kjo ka ndodhur më 19 mars 1873. Isha dhjetë vjeç. Kujtimet e fëmijërisë të ndjekin më gjatë se sa të tjerat dhe unë e kujtoj mirë këtë ditë dhe e kam kujtuar shpesh. Pas leximit, i cili, sipas kujtimeve të mia, nuk u bë lart, në dhomën e pritjes, por poshtë, në dhomën e tetkës unë nuk u largova por fillova ta shfletoja vëllimin e Pushkinit. Fragmenti "Mysafirët u mblodhën në vilë", m'u duk i mërzitshëm dhe më erdhi keq që nuk vijonte. E vendosa librin në tavolinë, të hapur pikërisht te ky fragment. Hyri babai, mori librin dhe tha: "Ja si duhet shkruar!". I kujtoj mirë këto fjalë veçanërisht, sepse atëhere ngela pa mend pse atij i pëlqeu ky fragment."

CILA ISHTE VAJZA E MADHE E PUSHKINIT?

Maria Aleksandrovna Hartung, vajza e madhe e Pushkinit, lindi më 19 maj 1832, kurse emrin e mori nga gjyshja e poetit, Maria Aleksejevna Hannibal. Që në fëmijëri ajo ishte shëndetligë dhe kjo e shqetësonte shumë Pushkinin. Ka shumë letra të tij, ku babai i kujdesshëm interesohet për shëndetitn e të bijës: "A flet Masha? A ecën? Po dhëmbët? Ç'bën Puskina ime pa dhëmbë?"

Maria ishte i vetmi fëmijë i poetit, që gjithsesi mbante mend diçka nga i ati. Kur Pushkini vdiq, ajo ishte pesë vjeçe. Si bijë oborrtari, Maria mori arsim të veçantë në shtëpi. Në moshën nëntë vjeçe fliste dhe lexonte rrjedhshëm frëngjisht dhe gjermanisht, luante në piano dhe ishte një kundërshtare e denjë në shah për edukatorët e saj.

Bukuria e Marisë bëri për vete shumë adhurues që t'i vinin rrotull, por të gjitha propozimet i refuzone. Por zemrën e saj e rrëmbeu general-majori Leonid Hartung. Ajo ishte atëherë 28 vjeçe ndërsa Leonidi, 26 vjeç.

Pas 17 vjet të jetës bashkëshortore, Leonidin e akuzuan për vjedhjen e kambialeve dhe letrave me vlerë të një hebreu fajdexhi. Akuzat ishin të rreme, por Hartung, viktimë e një intrige, nuk mundi ta dëshmojë pafajësinë e tij, dhe kur trupi gjykues u tërhoq për të dhënë vendimin, ai vrau veten brenda në sallën e gjyqit, për t'i shpëtuar turpit. Në xhep i gjetën një letër me fjalët: "betohem para gjithëfuqishmit Zot, nuk kam vjedhur asgjë dhe armiqtë e mi i fal."

Humbja e bashkëshortit ishte një goditje fatale për Maria Aleksandronën. Në një letër drejtuar të afëmve të saj, ajo shkruan; "Kam qenë e bindur që në fillim të procesit në pafajësinë e tij nga tmerret, që akuzuan burrin tim... Ai i fali të gjithë armiqtë e tij, por unë nuk i fal."

Sa ishte gjallë ajo i mbeti besnike burrit, me të cilin nuk pati fëmijë. Maria jetoi tek të afërmit, ndihmonte në edukimin e fëmijëve dhe ishte shumë vepruese në gjithçka që kishte lidhje me babain e saj. Më 1880, së bashku me dy vëllezërit dhe motrën ishte e pranishme në ngritjen e monumentit në Moskë (Maria do të shkonte te monumenti i Pushkinit në Tvjerskij Bulvar, në kohë të mirë apo të keqe, deri në ditët e saj të fundit.)

Maria iu drejtua për ndihmë perandorit, i cili lidhi një pension prej 240 rublash në muaj. Në vitin 1889, në njëqind vjetorin e lindjes së Pushkinit, pensionin ia rritën deri në 300 rubla.

Më 1900 u hap në Moskë një biblioteké-leximi me emrin Pushkin, të cilën e drejtoi Maria Aleksandrovna. Ajo punoi atje deri më 1910, aq sa e lejoi shëndeti.

Kur erdhën bolshevikët në pushtet, ia hoqën pensionin, duke e lënë të moshuarën e mjerë pa asnjë mbështetje. Ndërkohë që makina burokratike shqyrtonte "shkallën e nevojës", bija e Pushkinit vdiq nga uria më 7 mars 1919. Dokumentin për caktimin e pensionit e kishte firmosur personalisht Lenini, por ky pension i parë shkoi për të shlyer shpenzimet e varrimit të saj.

Katër fëmijët e Pushkinit. Maria, e dyta majtas

Librat më të mirë të vitit 2019

Bukinist
pasioni për librat

LEXIMTARI

Për të katërtin vit radhazi *Bukinist* dhe *Leximtari* përmbyllen me sukses procesin e përzgjedhjes së librit më të mirë të vitit, përmes përzgjedhjes paraprake të shtatë librave në gjashtë kategori dhe të votimit online për një periudhë disa-javore. Fituesit për vitin 2019 janë librat: "Kakarina" në kategorinë e librit për fëmijë, "N nji fije t'thelle gjaku" nga Ledia Dushi në kategorinë poezia shqipe, "Diktatori në kryq" nga Mira Meksi në kategorinë romani shqip, "Ishulli" nga Aldous Huxley sjellë në shqip nga Rudi Erebara për kategorinë romani i përkthyer, "Mbreti Zog pas dyerve të mbyllura" nga Erald Kapri në kategorinë "non-fiction" dhe "Forca e faktit" nga Hans Rosling për kategorinë e zhvillimit personal.